

## Procesverbal

Nga mbledhja X (e dhjetë) e rregullt e Kuvendit Komunal në Dragash , e mbajtur më datë:  
29.12.2023

### Rend Dite

- 1) Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara (procesverbali i seancës IX të rregullt dhe procesverbalet e tri seancave të jashtëzakonshme);
- 2) Vendim për shpalljen e Listës së Përgjithshme dhe Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës për vitin 2024;
- 3) Miratimi i Planit të Punës të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës 2024-2026;
- 4) Rishqyrtimi i Vendimit për korrigjim në listat kadastrale 01Nr.060/01-8154-2/23 i datës 27.04.2023;
- 5) Miratimi i Planit të Punës të KKSB-së për vitin 2024;
- 6) Kërkesa për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës e z.Samir Krasniqi 01Nr.462/01- 31857;
- 7) Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës; dhe
- 8) Eventuale.

**Mehmet Spahiu:** Përshëndetje kryetar, drejtorë, asambleiste dhe asambleistë, media dhe ju qytetarë të Komunës së Dragashit! Hapi Mbledhjen X (e dhjetë) të rregullt, të trembëdhjetën me radhë për vitin 2023 të Kuvendit Komunal të Dragashit. Njëherit propozoj këtë rend dite. Ju sigurisht që përmes formës elektronike e keni marrë rendit e ditës. Megjithatë, unë po jua rikujtoj edhe një herë:

- 1) Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara ( procesverbali i seancës IX të rregullt dhe procesverbalet e tri seancave të jashtëzakonshme);
- 2) Vendim për shpalljen e Listës së Përgjithshme dhe Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës për vitin 2024;
- 3) Miratimi i Planit të Punës të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës 2024-2026;
- 4) Rishqyrtimi i Vendimit për korrigjim në listat kadastrale 01Nr.060/01-8154-2/23 i datës 27.04.2023;
- 5) Miratimi i Planit të Punës të KKSB-së për vitin 2024;
- 6) Kërkesa për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës e z.Samir Krasniqi 01Nr.462/01- 31857;
- 7) Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës; dhe
- 8) Eventuale.

A dëshiron dikush të marrë fjalën? Urdhëroni, z.kryetar!

**Bexhet Xheladini:** Te nderuar delegatë, qytetarë, media! Para se të miratohet rendi i ditës për këtë mbledhje të Asamblesë, unë kam një propozim, që pika “Kërkesa për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës...”, të cilën e ka parashtruar z.Samir Krasniqi, të hiqet nga rendi i ditës dhe kjo të shqyrtohet në njërën nga mbledhjet e ardhshme të Asamblesë. Arsyeja është se Drejtorati i Urbanizmit kërkesën e ka refuzue. Prona të cilën ai ka kërkuar të bëjë ndërtim të përkohshëm është

pronë e Agjencionit të Pylltarisë. Gjithashtu, është edhe një vendim i mëhershëm i kryetarit të Komunës, që të ndalohen ndërtime në atë zonë. Na pasi e kemi në plan këtë vit, vitin e ardhshëm me e ndërrue Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartat Zonale me i miratue, atëherë propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet dhe të shqyrtohet pas miratimit të PZHK-së. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.kryetar! Dëshiron dikush tjetër? Fjalën e ka Suada Bajrami.

**Suada Bajrami:** Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar, kolegë asambleistë dhe ju të tjerë! Unë kërkoj që në këtë rend të ditës të shtohet edhe një pikë tjetër, të cilën ne si Grup i Grave Asambleiste, në bashkëpunim me OSBE-në, e kemi bërë një raport. Një pikë tjetër me titull “Të drejtat e grave dhe barazia gjinore”. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, Suada! Fjalën e ka Shpetim Hajredini.

**Shpetim Hajredini:** Faleminderit, i nderuar kryesues! Përshëndetje, të nderuar kolegë, qytetarë të nderuar të Dragashit! Do ta replikoj pak kryetarin, se u bë e tepërt. Po na vijne pika të rendit të ditës, po i bina këtu dhe pastaj po i largojmë, për një arsytim të cilin e dha kryetari që, për mu, qysh në ditën kur ka ardhë kjo pikë e rendit të ditës, unë e kam ditë që kjo pikë largohet, për shkak se është e jashtëligjshme. Nuk mund të jepet një pronë komunale direkt pse na ka ardhë neve, vetëm po e lyp Shpetim Hajredini pronën edhe na po ia japim atij zotnisë. Nuk jam kundër për këtë person, kushdo që të jetë prej qytetarëve të Dragashit, unë jam për t’i ndihmuar, mirëpo duhet t’i ndjekim rregullat. Shumë janë të qarta ligjet dhe nenet të cilat janë të specifikume nga ministrinë përkatëse. Prandaj, kur kërkohet një pronë komunale, së pari duhet ta lexoni ligjin dhe pastaj të na dërgoni neve ta kemi këtu si pikë të rendit të ditës. Sepse, na po dalim keq. Unë nuk po e di tash a po e bëni me qëllim që të na qitni neve keq, se ne ndoshta nuk e votojshim vetëm pse është e jashtëligjshme, apo ku e keni qëllimin? Por, duhet të keni kujdes që në seancat e ardhshme së pari shikoni, të lexoni ligjin dhe pastaj të na bini pikat e rendit të ditës. Ju e dini që Ligji për pronat komunale – e kemi diskutue edhe më herët, jua kam lexue edhe Ligjin – se pronat komunale jepen vetëm në ankand publik dhe kur ka ndonjëherë ndonjë interes të lartë që, për shembull po e marrim KEK-un apo gjëra të tilla që janë në interes të përgjithshëm shtetëror, atëherë mund t’i japësh edhe direkt, por edhe investimi duhet të jetë që të përputhet direkt me buxhetin e komunës, që i bjer 10%-shi i investimeve. Në këtë moment, 1 milion e 200 mijë duhet të investojë për me ia dhënë direkt. Përndryshe, kjo pikë e rendit të ditës është mirë që e largove, në të kundërtën, e aprovonim ne apo jo, nga Ministria do të na u kthejke mbrapsht. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Shpetim! Dëshiron dikush tjetër ta marrë fjalën rreth rendit të ditës? Siç po duket nuk ka të interesuar. Suada, nëse ka mundësi një shpjegim, a keni ndonjë material për këtë pikën që e propozuat? A ka mundësi me e lënë në “Të ndryshme”, me debatue për këtë çështje? Atëherë po e lëmë në “Të ndryshme”. Para se me e votue rendin e ditës, duhet ta vërtetojmë a e kemi kuorumin apo jo. Kërkoj nga shërbimi i Kuvendit ta konstatojë kuorumin! Kuorumin e kemi, 25 asambleistë jemi

prezentë. E hedh në votim rendin e ditës. Urdhëro, Driton!

**Driton Ademi:** Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë! Kryesues, kolegja Suada e lypsi si kërkesë, po ti duhet me e hedhë në votim. Nuk ka nevojë për një pikë të rendit të ditës, nuk ka nevojë për me e hedhë në pikën “E ndryshme”. Kështu që, ajo mundën me e diskutue ose çka ka me sqarue, se është propozim. Propozimi del në votim, nëse miratohet propozimi, atëherë jepni sqarim mbrapa.

**Mehmet Spahiu:** z.Driton, për këtë qëllim unë edhe e kërkoja pëlqimin e Suadës, e cila ishte propozuese e kësaj pike të rendit të ditës. Ajo u dakordua që kjo të debatohet në pikën “E ndryshme”.

**Driton Ademi:** Jo, nuk ke në dijeni për atë. Por, kur të bëhet një propozim, është mirë me e hedhë në votim një herë më së pari, me hedhë propozimin në votim, masnej i hedhish edhe krejt pikat e rendit të ditës. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Shumë faleminderit, Driton! E hedh rendin e ditës në votim, me propozimin e kryetarit që të hiqet nga rendi i ditës pika e gjashtë, edhe me propozimin e Suada Bajramit që pika për të drejtat e grave në komunitet të debatohet në pikën eventuale. Kush është pro këtij propozimi? Kundër këtij propozimi kush është? Abstenim? 13 janë pro, kundër asnjë, 1 ka abstenuar, konstatojmë që miratohet rendi i ditës me shumicë votash. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës: Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara (procesverbali i seancës IX të rregullt dhe tri procesverbaleve të jashtëzakonshme). Dëshiron dikush ta marrë fjalën rreth kësaj pikë? Urdhëro, fjalën e ka z.Nedžmidin Sejdilar.

**Nedžmidin Sejdilar:** Zoti Kryesues, mendoj se keni bërë një gabim procedural. Këtu, përveç propozimit të zonjës Bajrami, kemi pasur edhe një propozim të kryetarit. A mund të na shpjegoni zoti Kryesues se cila është axhenda jonë? Prisja që ne të votonim për secilin propozim individualisht.

**Mehmet Spahiu:** Më fal, Nexho! Duhet të flasësh vetëm për pikën e rendit të ditës. Është miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara. Çështja e rendit të ditës është mbyllë, është votuar, andaj rreth kësaj nuk ke çfarë të diskutosh. Çështja e rendit të ditës është mbyllur. Kjo çështje që e ngrite ti, z.Nedžmidin. Edhe nuk më vjen mirë që të shprehësh ashtu ti, i çmendur apo gllup, si e theksove, se nuk kam qef që në radhët e asambleistëve të kemi njerëz të tillë. Prandaj, tjetrën herë të kesh kujdes kur të paraqitesh këtu. Çështja e rendit të ditës, thashë, është mbyllur. Tash po diskutojmë për procesverbalet nga mbledhja e kaluar (procesverbali i seancës IX të rregullt dhe tri procesverbaleve të jashtëzakonshme). Kush dëshiron që të marrë fjalën rreth kësaj? Nëse nuk ka asnjë, siç po duket s’ka të interesuar, e hedhim në votim pikën e parë të rendit të ditës. Kush është pro miratimit të procesverbaleve? Kundër? Abstenim? Me 14 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet pika e dytë e parë të ditës. Kalojmë në pikën e dytë: Vendim për shpalljen e Listës së Përgjithshme dhe Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës për vitin 2024. Dëshiron dikush nga ekzekutivi të marrë fjalën rreth kësaj pike, të japë ndonjë shpjegim? Fjalën e ka z.Qamil Kolloni.

**Qamil Kolloni:** Përshendetje kryetar, kryesues, delegatë dhe të gjithë ju të pranishëm! Duke u bazuar në Nenin 13 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare nr.10, 3 prill 2019, dhe ligjit në fuqi për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, jemi të detyruar që deri para datës 31 dhjetor të vitit kalendarik të bëhen publike dhe të qiten në uebfaqe pronat e përgjithshme komunale dhe pronat e veçanta, të cilat parashihen përgjatë vitit 2024, të jepen në shfrytëzim. Në kuadër të këtyre pronave, në kuadër të pronave të përgjithshme, nga 122 kemi mbërri në shumën totale të pronave, ku kemi krijuar një Komison që gjatë vitit ka bërë verifikimin e parcelave dhe njëkohësisht, në bazë të vendimit të Qeverisë që këto prona të cilat kanë qenë me një numër të përgjithshëm, të evidentohen dhe të bëhen numrat kadastralë, gjeodezike, secilës parcelë veç e veç t'i jepet nga një numër, është rritur në 144 prona në përgjithësi, të cilat janë të gatshme dhe mund të jepen në shfrytëzim ose të bëhen analizat për një pjesë të tyre. Prej tyre, gjatë vitit 2024 kemi 81 prona. Në kuadër të 81 pronave të cilat janë në Listën e Veçantë për dhënie në shfrytëzim, 32 kontrata janë të lidhura, mirëpo detyrimisht duhet të parashihen, sepse gjatë vitit 2024 edhe këtyre shfrytëzuesve të tokës duhet t'u rinovohen kontratat. Njëkohësisht, nga këto kontrata kemi edhe disa nga Komisioni i cili është duke bërë vlerësimin fizik të disa objekteve ku pronarët kanë heq dorë dhe ato paraqesin rrezik për qytetarët, janë në verifikim e sipër. Mendoj që gjatë vitit 2024 do të arrijmë që përfundimisht të gjitha pronat e Komunës t'i pajisim me kontrata dhe të gjitha ato objekte të cilat i kemi në shfrytëzim dhe janë të detyruara t'i qesim në ankand publik, besoj që në muajin tjetër, në janar, do t'i kemi të gjitha ato prona komunale, që t'i zhvillojmë procedurat për dhënie në shfrytëzim përmes ankandit, siç e parasheh ligji. Prandaj kisha kërkuar nga ju, delegatë të nderuar që, siç keni vepruar bashkërisht prej vitit 2022, edhe këtë vit ta miratoni këtë listë të përgjithshme, njëkohësisht edhe listën e veçantë për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale.

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Qamil! Dëshiron dikush tjetër të marrë fjalën rreth kësaj pike? Fjalën e ka Driton Ademi.

**Driton Ademi:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje edhe një herë për të gjithë! Atëherë, po i drejtohem drejtorit për këto prona. Kërkesa ime qysh në vitin 2022, drejtor, ka qenë që këto prona të mos janë me kode, por të janë edhe me emra. Ti prej 2022-tës nuk e ke prurë. Qytetarët, me sa unë kam informacion, po foli veç për Bresanë që i pashë disa kode, as që janë në dijeni ata qytetarë që po iu del prona në ankand, që po jepet në shfrytëzim. Një pjesë e tyre. Ata a nuk e meritojnë me me ua çue një kërkesë paraprakisht atyre, me i njoftue. Te ato prona kanë investue, edhe na qetash po ia japim kontratat njëvjeçare atyre. Unë mendoj që ata e meritojnë me me ua çue një kërkesë paraprakisht, me e ditë cilat prona. Na me kode mundim me hy me e gjet, nuk e di kërkuar, shumica nuk e dinë që është një faqe si Gjeoportali-ks a qashtu diçka, për më hy me i kqyrë këto prona. Domethënë, shumë njerëz, qytetarë që kanë prona, me këto kode nuk janë në dijeni cilat prona kanë me dalë me u dhënë në

shfrytëzim. Unë po propozoj, të kam thënë edhe në vitin 2022, me sa e mbaj në mend në seancën e tretë a të katërt, që këto prona kur të vijnë për me u dhënë në shfrytëzim, të jepen edhe me emër, jo vetëm me kode, se rrallëkush mundën me i gjet ato. Edhe e dyta, një kod që mu më ka ra për çudi në Bresanë, për shembull, një kod 01326, se e ke të shkruar qaty, përshkrimi i këtij kodit është mbrapa – na që i thona – Domit. Çka jeni duke dhënë aty? Një kod që më ka ra në sy, domethënë që e kam pa. Jeni duke e dhënë, si me thënë, sheshin me e dhënë. Nuk jeni duke dhënë asnjë lokal aty. Nëse unë jam gabim, qysh e kam pa me kod, ta lexova edhe kodin, është duke e dhënë domethënë sheshin. S’ka as lokal as kurgjo aty. Edhe pyetja e fundit që e kam drejtor për ty: Sa prona janë pajis me kontratë, prej që e kemi miratue vjet në 2022-tën, sa prona janë pajis me kontratë në 2023-tën? Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Driton! Fjalën e ka z.Agron Gashi.

**Agron Gashi:** Ju përshëndes të pranishëm, përshëndetje kryetar, përshëndetje për juve kryesues dhe të gjithë kolegët e tjerë asambleistë! Meqenëse kaluan dy vite dhe këto kontrata që i përmende deri më tash, për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, në fakt ju dëgjova me vëmendje se sa është numri i tyre, por e tëra që duhet të dinë edhe qytetarët edhe ne asambleistët, deri këto dy vite a janë përgjigjur pagesave siç i keni caktuar ju, ne Komuna dhe ekzekutivi i kësaj Komune, a kanë ngelur borxhe deri më tash, dhe qeverisja juaj, duke u zotuar për një qeverisje më të mirë, që mos të ketë pas përfundimit të mandatit borxhe të theksuara, pastaj për të ardhur për t’i falur ato. E tëra që dua të pyes, a i janë përgjigjur pagesave me rregull deri më tash për këto prona që po i shfrytëzojnë. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Agron! Fjalën e ka z.Artan Loshaj! Urdhëroni!

**Artan Loshaj:** Përshëndetje për të gjithë! Dje edhe në Komitet kam kërkuar nga kryetari dhe drejtori disa informacione. Na ka premtue që sot do të na japë drejtori. U fol edhe nga kolega ma herët, unë veç do ta vazhdoj. Janë, thajë drejtor, 144 prona dhe 81 janë të veçanta. Nga këto 81 prona të veçanta, 32 kanë kontrata. Unë ma herët ta kam kërkuar ty listën e pronarëve të cilët i shfrytëzojnë këto, sa borxhe kanë. Ta kam thënë në seancë, ta kam thënë në Komitet, po ta përsëriti sot. Të kam thënë që disa i ke të partisë, disa i ke dosta dhe disa i ke që s’po mundesh me ua çue fletën për pagesë. Na ke premtue dje që sot do të na biesh listën e borxhlinjve, të cilët kanë borxh për qeto prona që janë në menaxhim të Komunës së Dragashit. A ka mundësi sot me na dhënë një sqarim?

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, Artan! Dëshiron dikush tjetër të marrë fjalën? Drejtor, a dëshironi të jepni sqarime? Fjalën e ka drejtori Qamil Kolloni.

**Qamil Kolloni:** Faleminderit për pyetjet! Në radhë të parë Driton për ju. Duhet ta dish se këto prona jepen me shifra, për arsye se pronar është Komuna. Në këtë pronë të Komunës kanë të drejtë të gjithë, në momentin kur i skadon kontrata, të aplikojnë edhe ta marrin. Këto, në bazë të ligjit, nuk jepen me emër dhe me mbiemër. Sa i përket njoftimit, si në vitin 2021, si në 2022, si në 2023, ne u çojmë njoftimin përfundimtar. Secili shfrytëzues i pronës komunale, në një njoftim përfundimtar për borxhet,

për afatin, për skadimin e afatit dhe për të drejtën e shfrytëzimit. Ne jemi në kontakt në vazhdimësi e sipër. Për shifrën të cilën ti e thuesh, vlen Rregullorja për dhënien në shfrytëzim nën një vit, dhe lokalet që janë rreth sheshit në Bresanë kanë të drejtë me aplikue, me marrë për çështje sezonale, për tre muaj me vu karrika. Dhe, ne në bazë të kësaj e parashohim se ai shesh, në qoftë se na paraqitet dikush, këtij numri ia japim një të drejtë, a një ari apo dy ari, 10 ari, varësisht prej kërkesës dhe kjo është shumë mirë e rregullume. Sa i përket kontratave, po të tregoj se nga 144, 81 janë pa kontrata. Të gjitha tjerat janë që i ka dhënë Qeveria, 10 vite, 15 vite, 12 vite, 7 vite, janë kontrata valide të cilat ekzistojnë në sirtar të Komunës, për shfrytëzimin e pronës komunale. Një pjesë e këtyre kontratave janë toka, një pjesë janë objekte, një pjesë janë edhe tokë edhe objekte. Të gjithë këta qytetarë janë të njoftuar, vetëm kanë hamendje ata të cilët duan të hamenden ose ata të cilët nuk e kanë krye obligimin dhe kanë borxhe ndaj Komunës. Sa jën borxhe? Unë, edhe pse nuk jemi realisht në pikë të rendit të ditës për të folur për borxhet, po ju jap një pasqyrë të shkurtë. Në vitin 2021 këtë Komunë e kemi gjet me 317,958 euro borxhe, që i kanë për shfrytëzimin e pasurisë komunale. Nga 317,958, sot kur po raportojmë në vitin 2023, kemi 155 mijë euro borxh të tokave. Do të thotë, falë edhe Vendimit tuaj prej 40%, diku 40 mijë euro dhe 162,912 euro që janë mbledhë ma tepër, na kemi 155 mijë euro. Ju vitin e kaluar e keni parë se kemi pas 167 mijë euro të hyra vetanake shtesë. Në qoftë se doni, unë i kam edhe të hyrat e këtij viti, por unë mendoj se për të hyrat dhe shpenzimet ne e kemi, ju e dini, afatin e rregullt që na janar raportojmë për tërë vitin. Në qoftë se keni dëshirë, unë jam i gatshëm në çdo kohë, në gjys të natës, me ju raportue për çështje profesionale. Sa i përket politikës, nëse doni po bëjmë politikë. Mu po më vjen keq që ky Artani, po mundohem me i ik, po unë e kam jaran këtë, edhe këtij nuk i kam çue. Se po pres, le ta regjistrojë biznesin, le t'i del në sistem, nuk po ia çoj me e regjistruë. Këtij nuk ia kam çue, por këtyre tjerëve, janë dokumentacionet se të gjithëve iu kanë shkue me postë. Janë 144 njoftime përfundimtare. Prandaj është mirë që këtë shoqëri me e rujt pak më tepër, se unë ty të kam pas kojshi edhe shok. Dhe, mos paragjyko kës gjëra, sepse po mundohesh gjithmonë me gjujt gurin edhe me e fsheh dorën. Në qoftë se ke, thuaje me emër, burrisht, edhe të hyjmë ta diskutojmë. Në qoftë se unë atij nuk i kam çue njoftim për borxhin, unë jap dorëheqje. Kaq! Mos u mundo me lujt lojna edhe me e shfrytëzue këtë këtu, se ke një personalitet që nuk merret me lojna edhe fjalë të çajtoveve. Unë nuk lejoj që kur të teket ty... unë kurrë nuk kam bisedue për spitalin tënd, çka bëjsh atje. Dhe ti të marrësh të drejtë, me këtë fjalor të sillesh me mu. Po më vjen keq, po unë ty të kam shok. S'ta kam çue letrën.

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.drejtor! Meqenëse iu apostrofue emri Artanit, fjalën e ka Artan Loshaj.

**Artan Loshaj:** z.Drejtor, një herë bonu ma i sjellshëm pak me mu, se unë nuk ta përmenda asnjë diçka personale. Nën një, unë biznesin timin nuk kam, e dish shumë mirë. Artan Loshaj nuk ka biznes. E dyta, në qoftë se duesh personale me pas me mu, une nuk lëshohem me ty në këtë seancë, por lëshohna

jashtë kur të dalim, bisedojmë, vij në zyrë. Ti e përfaqësojsh këtu drejtorin e Financave, nuk e përfaqësojsh Qamil Kollonin këtu. Jo mos u nxej, kadale, mos i jep zor shumë, unë e di që ti s'ke edukatë shumë, po të thashë me mu personale mos e qit, se unë biznes temin nuk kam. Unë e di ku po aludojsh, po aludojsh në biznesin e grues teme. Ai biznes është i regjistruar prej vitit 2016, shko poshtë kqyre, edhe mos e qit shumë personale, se burrat e lig sikur ti merren me gratë. Edhe ajo është e drejtë e saj, është mbi moshën 18-vjeçare edhe të drejtat e grave janë ndryshe. Me mu mos u merr, se kam me të padit për shpifje. Unë, Artan Loshaj, nuk kam biznes, e kuptojsh? Unë jam punëtor i spitalit edhe jam asambleist. Mos u merr me gratë, mos u merr me çëshjte të huaja, se ti nis e sos je marrë me gra, po mos ta qesim shumë personale, se pale ku na del.

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, Artan! Dëshiron dikush tjetër të marrë fjalën rreth kësaj pike? Fjalën e ka Shpetim Hajredini.

**Shpetim Hajredini:** Atëherë, përshëndetje edhe një herë për të gjithë! I nderuar drejtor, shumë herë bre e kam thënë, po s'po e di pse prapë po e vazhdoni të njëjtën. Pyetja po të parashtrohet si drejtor, ktheja si drejtor edhe mos delni personale, se nuk është në rregull. Se po dalim keq, secili po e njohim njëri-tjetrin. Politika është politikë, edhe dy vite i kena, kur të dalim politikë, bojna politikë edhe krejt në rregull jena. Këtu jena për me punu për qytetarët. Ta parashtroni pyetjen, jepja përgjigjen. Shumë në rregull ke qenë deri tash, në fillim e more pak me hov, pastaj je konë shumë në rregull, ke dhënë përgjigje si duhet. Nuk po e shoh të arsyeshme kështu, unë për vete u ndjeva shumë keq. Po delni në personale, kjo nuk është në rregull. Prapë ju vazhdoni me të juajën, ju e dini, po sa më përket mu, kjo është...s'po ma pranon ndërgjegja jeme edhe qekjo fytyrë e jemja. Me i bo këto gjona edhe para qytetarëve me dalë me thonë këso fjalë, këso akuza, nuk është në rregull. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Shpetim! Më falë drejtor, fjalën e ka Nexhat Selaj.

**Nexhat Selaj:** Faleminderit! Përshëndetje për të gjithë! Edhe unë do të isha ndalë pak, drejtor, fjalimin e parë, i bëmë qe dy vite, aso fjalim të parë që na prezantove, nuk e di a ka notë ma të madhe se dhjetëshe. Ishe aq i prerë, ishe aq i vëmendshëm, u mundove me na bind që edhe natën me na informue. Në aspektin profesional je i matur edhe je i përgatitur, edhe dhjetëshe ta dhashë. Deshta me dalë me të falënderue për atë fjalim që na sqarove. Për pjesën tjetër, kisha kërkue edhe nga ju, edhe nga Artani, por fillimisht, fillove me e nxit pak. Të jemi pak më të durueshëm. Për pjesën e parë, nëse ka ma tepër se dhjetëshe unë të kisha vlerësue, për pjesën e dytë jo. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Nexhat! Fjalën e ka drejtori Qamil Kolloni.

**Qamil Kolloni:** Të nderuar delegatë, faleminderit shumë për sugjerimet! Janë dy vite, janë mbledhjet e KPF-së që vijnë vazhdimisht ngacmime. Me fjalën 'shokët e tu' duhet t'i tërhiqni edhe kolegës suaj vërejtjen. Nuk është 'shokët e tu', le ta qet faktin, ciët shokë, cila firmë nuk e ka marrë njoftimin përfundimtar. Unë jap përgjegjësi, po unë jap edhe dorëheqje. Unë jam personalitet që nuk luaj, të ka

dhënë veç sqarime profesionale. Kjo është me prek në integritetin tim. Unë nuk lejoj një djal i ri, disa herë ia kam tërheq vërejtjen, mos hyj në një tabor në të cilin nuk duhet me hy. Sa hyj unë në spital për të, ai hi në profesionin tem. Plus asaj, e përgjithëson problemi, shokët. Të lutem, thuaje kush janë shokët, këtë po kërkoj. Askujt nuk i kam bërë të padrejtë dhe në aspektin profesional nuk lejoj kujt t'i teket e çka t'i teket të thotë. Pikë! Kjo është kërjesa. Kush e qiti në aspektin personal? Kush përmendi shokë? A unë kesh apo ke ai, që e boni pyetjen që e evidentova decidivisht. Po nuk e di të tjerët çka ka thonë në KPF. Dhe, detyrimisht për çdo vjet bën të njëjtën gjë. A unë do t'i rri rojë këtij? Le ta kursejë pak vetveten, që të lëje vend për me kurseje. Përndryshe, unë me kërkond nuk jam marrë, përveç me probleme profesionale. Dhe, nuk ia lejoj vetvetes, unë kam disa vjet, e kam ruajt dhe due me e ruajt me nder këtë personalitet që e kam. Hala kërkush në Gorë dhe në Opojë me gisht nuk ka mund me bo në drejtim temin dhe nuk ia lejoj një djalit, pse i teket, për huqe të veta politike, ose do me shit mend, ose me u bo kaskader këtu, me tregue kuse di, e s' di kurgjo, edhe vjen në fund integritetin personal të një individi me e vu në peshore. Për punë profesionale, gjë që nuk e njeh. Ju lutem, po e pranoj këshillën e juaj, por para se të më këshilloni, ndaljami spicat. Nuk bëhet kështu lojë.

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Drejtor! Artan, më fal, para teje është lajmërue Urani. Atëherë, urdhëro Artan!

**Artan Loshaj:** z.Drejtor, për i paedukatë e di që je, se e di, bashkë kemi bashkëjetue. Problemin personal temin, kurrë në jetë, ty edhe juve, nuk ta lejoj aspektin moral me më prek. Me ma përmend mu gruen teme këtu, lokalin që e ka të regjistruar e që s'ke pas guxim as vetë me pru ftesë për regjistrim, kurrë, po të them në sy, pushka top t'u bëftë, kurrë s'ta lejoj, ty edhe krejtve juve. Ti aspektin profesional s'po e durojsh. 14 vjet të kam durue, kqyri dëgjimet tua kur ke kandidue me marrë pushtetin, çka ke bo. Terr i zi e ke bo, shëndetësinë edhe Komunën edhe krejt, edhe ju kemi durue 14 vite. Aspektin profesional, ti në aspektin moral me e qit me mu, kurrë s'ta fali, prej pastruesit deri te kryetari. Tash edhe një herë po të them, pushka top t'u bëftë, a për këto që m'ke akuzue që kam biznes, kie me u padit. A, që e qesish personale edhe private, syri 'pët' s'më bon pej teje. E kuptojsh këtë?

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Artan! Gjuha e komunikimit të dritanishëm më duket gjuhë e ashpër. Unë kërkoj nga diskutuesit tjerë të përmbahen nga këto kualifikime, ngase duhet ta ruajmë autoritetin e përfaqësuesve të popullit. Jemi përfaqësues të një populli të mrekullueshëm edhe nga treva e Gorës edhe Opojës. Andaj, duhet të jemi përfaqësues të denj të këtij komuniteti. Urdhëro, z.Uran! Fjalën e ka Uran Halimi.

**Uran Halimi:** Faleminderit, kryesues! Përsëritet për të gjithë pjesëmarrësit! Sa i përket pikës së rendit të ditës, veçse u zbeh kjo pikë të rendit të ditës. E mora fjalën në lidhje me këto polemikat që, fatkeqësisht, po ndodhin. Drejtor, unë të kisha lut me u përgjigj në atë aspektin profesional. Ne si delegatë kemi të drejtë kapak edhe me të ngacmue, mirëpo ti duhesh me u përmbajt edhe mos me dalë

në personale. Delegatë ne jemi për me folë, me e shpreh mendimin tonë. Është mirë me e rujt rendin edhe qetësinë, se jemi Kuvend këtu edhe kemi ndjekës edhe qytetarë. Përmbahuni pak! Ti drejtor, realisht, s' duhet me u marrë me delegatë, me secilin veç e veç. E japish përgjigjen për të cilën je thirrë, domethënë për pikën e rendit të ditës, e jo me dalë në çështje personale. Secili munden me na provokue, më keni provokue edhe mu, e dini krejt, por jam përmbajt. Kryesuesi është mirë pak me e qetësue situatën, mos me lejue me dalë debati jashtë rregullave. Kështu që, ju kisha lut me u përmbajt! Drejtor, vazhdimisht e ke përdorë këtë taktikë, kur të është bo një pyetje që s'ta ka pëlqye, gjithmonë e ke qit në personale, po s'bën. Unë, prej foltores së kryesuesit, ta kam tërheq vërejtjen vazhdimisht për jo politikë. Ti je këtu profesionalist, nuk je i ftuar për politikan. Ty të kanë emëruë drejtor, nuk të ka zgjedhë kryetari drejtor, je i emëruar. Duhesh me e ditë vendin ku e kie. Ne jemi të votuar. Po të ishe konë delegat, kishe bo politikë. Qetash s'un bojsh politikë, drejtor. Qetash kallxojsh profesionalizëm. Faleminderit shumë!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Uran! Dëshiron dikush tjetër të marrë fjalën rreth kësaj pike? Fjalën e ka z.Agron Gashi.

**Agron Gashi:** Atëherë, ju përshëndes edhe një herë! Me shumë vëmendje e dëgjuam drejtorin që foli paraprakisht dhe kolegun Loshaj. Pat shumë paragjykime dhe stereotipe të llojeve të ndryshme, por megjithatë, ky drejtor ishte shumë konciz për situatën të cilën u përgjigj. T'i lëmë anash paragjykimet e kafeterive dhe të tjerë, por mbi të gjitha, drejtori ishte konciz, tha jep emrat e personave të cilëve nuk u kam dërguar fletushkën e borxheve apo diçka tjetër dhe unë, para juve, jap përgjegjësi morale, deri në dorëheqje. Dhe tash, kur të flitet, duhet të kesh të paktën edhe bazë për atë që flet dhe të kërkojmë përgjegjësi më tepër. Dhe drejtori po kërkon, jep emra dhe mbiemra të njerëzve të cilët i ka anashkaluar dhe nuk u ka dërguar. Dhe më këtë shumë i qartë ishte, nuk dua t'ia mbaj anën e drejtorit, por paragjykimet dhe stereotipet e ndryshme për të përfituar politikisht, duhet t'i anashkalojmë sepse kemi manifestime të shumta të cilët po e devijojnë situatën, nuk i kontribuojnë as qytetarëve, as kësaj Asambleje dhe as të ardhmes së këtij vendi. Kur të flitet, duhet të flitet me bazë, por jo me paragjykime. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Agron! Siç po duket nuk ka të interesuar për diskutim. Në shpjegimet që u dhanë nga drejtori, z.Qamil Kolloni, e hedhim në votim vendimin për shpalljen e Listës së Përgjithshme dhe të Veçantë të pronës së paluajtshme të Komunës për vitin 2024. Kush është pro miratimit të kësaj pike? Kundër? Abstenim? 13 vota janë pro, kundër asnjë dhe 6 abstenim, miratohet edhe pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës: Miratimi i Planit të Punës të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës 2024-2026. Ftoj Agon Baxhakun që ta marrë fjalën, si anëtar i Komisionit.

**Agon Baxhaku:** Përshendetje, i nderur kryesues! Të nderuar delegatë, i nderuar kryetar i Komunës, të

nderuar drejtor dhe të gjithë të pranishëm! Siç dihet, Komuna e Dragashit me anë të Ligjit për mbrojtjen e fëmijës dhe Udhëzimit Administrativ për themelimin dhe funksionalizimin e EDF-së, ka themeluar EDF-në dhe, në bazë të obligimeve ligjore që derviojnë nga ligji dhe udhëzimi administrativ, ka hartuar një Plan të Punës për EDF-në. Plani i Punës i EDF-së është hartuar nga anëtarët e Ekipit, në bashkëpunim me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë. Plani i Punës përmban objektiva nga fusha e shëndetësisë, mirëqenies sociale, arsimit, kulturës, rinisë e sportit. Në këtë plan është punuar gjatë, është mbajtur punëtori, si dhe punë individuale me zyrtarë të Komunës së Dragashit dhe është bërë një punë shumë e mirë dhe ky dokument përmban një gamë të gjerë të intervenimeve për të mirën e fëmijëve dhe për të drejtat e tyre. Plani ka kaluar nëpër të gjitha fazat si konsultimi me qytetarët, që është mbajtur me datën 13.12.2023 dhe ka qenë një muaj i publikuar në uebfaqen e Komunës për sugjerime dhe mendime nga qytetarët. Në fund përgëzohet Komunën dhe Ekipin për hartimin e këtij Plani dhe kërkoj nga ju si delegatë ta mbështesni me votim pro këtë Plan që na përket të gjithëve dhe specifikisht fëmijëve tanë. Faleminderit shumë! Nëse keni nevojë për sqarime më tepër, mundeni me parashtrë pyetje, unë do të jap të gjitha sqarimet e nevojshme. Faleminderit shumë!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Agon! Dëshiron dikush të marrë fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës? Driton Ademi e ka fjalën.

**Driton Ademi:** Faleminderit, kryesues! Deshta me i bo nja dy pyetje. Kush janë ekipi pjesëmarrës i hartimit të këtij drafti. Edhe, me sa kam informacion, nuk e di a u konë ndonjë anëtar i opozitës, se e pashë që edhe Asambleja Komunale tha, a u konë pjesëmarrës ndonjë anëtar i opozitës, nëse ka mundësi me e ditë. Faleminderit!

**Agon Baxhaku:** Në bazë të UA dhe Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve, kryetari i Komunës e themelon këtë Ekip. Në UA përfshihen, kryesisht është në nivel politik, për shkak se është e njëjta me EDF-në në kuadër të kryeministrisë. Neni 6 i UA, në përbërje të Ekipit është kryetari i Komunës – kryesues i Ekipit domethënë – Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, zëvendëskryesues; Drejtorja përkatëse për Arsim, domethënë drejtori i Drejtorisë; Drejtorja përkatëse për Shëndetësi; Drejtorja përkatëse për Rini, Kulturë dhe Sport; anëtar i deleguar nga KPF i Kuvendit Komunal; zyrtari për Mbrojtjen e Fëmijës dhe të Drejtat e Njeriut; Policia, domethënë është anëtare; Qendra për Punë Sociale dhe përfaqësues nga shoqëria civile. Këta janë përfaqësuesit e Ekipit, janë shumë qartë të specifikuar me UA dhe secili person i përfaqëson këto drejtori dhe në këtë cilësi është pjesë e EDF-së. Unë me emra nuk lëshohem, është Vendimi i kryetarit të Komunës dhe mund të gjendet lehtë. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Agon! Fjalën e ka Agron Gashi.

**Agron Gashi:** Atëherë prapë ju përshëndes! Ky ekip i cili duhet të veprojë në kuadër të edukimit dhe të drejtave të fëmijëve, unë po kërkoj pak sqarime të mëtejshme, ngase nuk po jam në dijeni. Ky ekip do të del direkt nëpër shkolla për të punuar me fëmijët për të drejtat e fëmijëve, do të ketë ekip special

për mësimdhënës për edukim të të drejtave të fëmijëve, të inkorporohen së pari mësimdhënësit, pastaj në mënyrë interaktive, gjatë procesit mësimor, që ata të mësojnë lidhur me të drejtat e tyre. Dhe, gjithashtu, është shumë me rëndësi se fëmijët nga vegjëlia, nga klasa e parë e më tej, duke u rritur, prej procesit mësimor, që mësimdhënësit, në kuadër të metodologjive interaktive, ndërvepruese, në mesin e njësive mësimore, të mësojnë vetë, çka janë të drejtat e tyre. Meqenëse sot kemi hasur në barriera të shumta, siç e dini, sidomos në proces mësimor, sepse fëmijët gjithmonë mendojnë se ata vetëm kanë të drejtë, duke mos e ditur se ku përfundojnë të drejtat e tyre. Në këtë aspekt, po them se ata edhe shpeshherë dinë ta destabilizojnë, ta dëmtojnë procesin mësimor, duke mos ditur se ku, thashë më herët, përfundojnë të drejtat e tyre. Andaj, kemi shumë goditje te personeli mësimdhënës, të cilët dalin jashtë kontrolli të kolegët e tyre, dhe unë tash dua të di a është një organizatë, një OJQ kjo, apo ka kuptim më ndryshe, por e tëra që duhet të them këtu është epiqendra kryesore, që DKA duhet të ketë një rol kryesor që, të paktën, me personelin arsimor, me mësimdhënës, të ketë një ndërlidhje më të madhe, me qëllim që ata të jenë profesionistë më të mirë, që t'i edukojnë fëmijët në mënyrë më të drejtë. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Agron! Nëse nuk ka dikush tjetër, fjalën e ka Agon Baxhaku.

**Agon Baxhaku:** Atëherë, përshëndetje i nderuar delegat! Në Plan janë parë edhe intervenimet që kanë me ndodhë në këta sektorë, te sektori i arsimit, ku pjesa më e madhe e fëmijëve kanë qasje në edukim. Sa i përket kësaj se kush ka me e bo, dokumenti është i Komunës, i Kuvendit Komunal. Besojmë që Kuvendi Komunal do të ndajë buxhet. Në Plan janë të specifikuar edhe ku ka me nda buxhet Komuna, ku kanë me nda buxhet donatorët. Edhe UNICEF-i gjithashtu do të participojë me disa pjesë të aktiviteteve të këtij Plani. Gjithashtu, me grante specifike për Arsim, një pjesë e buxhetit mundet me u orientue këtu, prej Grantit Specifik për Arsim. Gjithë këto intervenime janë paraparë me gjithë mësimdhënësit, jo me të gjithë, por me shumicën që kemi pas kontakte dhe kanë çue kërkesa në DKA, te zyrtarët që janë në DKA. Kemi punue ngushtë edhe kemi arrit të krijojmë këtë Plan. Gjithë këto, përveç aktiviteteve, i kemi edhe rezultatet se qysh mendojmë me e ndryshue këtë gjendje. Me përmirësue, me fillue dhe me e funksionalizue gjithçka. Për shembull, na kemi investue, këtu është e paraparë në Plan, si Ekip, që Kuvendi Komunal të investojë në hapjen e çerdheve edhe me nda mjete për këtë punë. Gjithashtu, si Ekip i kemi bërë kërkesë Ministrisë së Arsimit për buxhetim të një çerdheje tjetër më Dragash. Këto janë pak a shumë ato çka mundim me i përmbledhë. Plani është publik, besoj ju e keni si material. Të gjitha aktivitetet këtu është edhe kush ka me i krye. Kryesisht është DKA-ja dhe MASHT-i që i ka obligimet e veta për Komunën. Tash me grantin specifik ka me u nda edhe një buxhet për secilën komunë, edhe komuna ka me e bo një plan qysh munden me i shfrytëzue qato mjete të grantit specifik. Nëse nuk isha i qartë, të lutem! Faleminderit shumë!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Agon! Nëse nuk ka diskutime tjera rreth kësaj pike, e hedhim në votim pikën e tretë të rendit të ditës, miratimi i Planit të Punës të EDF-së 2024-2026. Kush është pro

miratimit? Kundër a është dikush? Abstenim? Me 25 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt: Rishqyrtimi i Vendimit për korrigjim në listat kadastrale 01Nr.060/01-8154-2/23 i datës 27.04.2023. Për sqarime fjalën e ka kryetari. Urdhëro, z.kryetar!

**Bexhet Xheladini:** Të nderuar asambleistë! Siç e dini, kemi marrë një informatë nga Shërbimi Pronësor-Juridik, nga Kadastri, që janë 14 parcela në zonën kadastrale ‘Pllava 2’, pa pronësi, me pronësi NN. Me të marrë këtë njoftim, ne në njërën nga mbledhjet e Asamblesë kemi marrë një vendim që këto prona të regjistrohen në pronësi të Kuvendit Komunal të Dragashit. Mirëpo, ky vendim i marrë nga Asambleja Komunale është kthyer mbrapsht nga Ministria, që Asambleja ta bëjë rishqyrtimin e këtij vendimi. Një ndër arsyetimet se pse Ministria e ka kthye mbrapsht këtë vendim të Asamblesë Komunale, është se ish-drejtori i ‘Sharrprodhimit’, gjoja se ka deklaruar se kjo pronë ka qenë e ‘Sharrprodhimit’ dhe ajo e ka pas në shfrytëzim. Në ndërkohë, ne kemi marrë një deklaratë të ish-drejtorit të ‘Sharrprodhimit’, z.Njazi Tërshnjaku. Kjo është deklarata e tij, të cilën unë nuk po e lexoj krejt, por vetëm pasusin e fundit. ‘Kjo tokë asnjëherë nuk ka figuruar në pronësi të Ndërmarrjes ‘Sharrprodhimi’. Kështu që, unë propozoj që ky Kuvend ta marrë një vendim që këto 14 prona, parcela, në zonën kadastrale ‘Pllava 2’, të kthehen dhe të regjistrohen si pronë e Kuvendit Komunal. Faleminderit! Janë sipërfaqet këtu, janë fletat poseduese të gjitha, i keni në material. Ka sipërfaqe disa hektarë. Janë 14 prona, mundeni me i pa në material. Propozimi im është që, edhe një herë të provojmë, ta marrim një vendim që këto prona të regjistrohen si pronë e Kuvendit Komunal, duke marrë parasysht deklaratën e ish-drejtorit të ‘Sharrprodhimit’. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.kryetar! Për fjalë paraqitet Urani. Urdhëro, z.Uran Halimi!

**Uran Halimi:** Përshëndetje edhe një herë! Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, ne e kemi Ministrinë e cila e ka kthye prapë këtë vendim, edhe po besoj që e ka bazhue në ligje të Kosovës, se aty thuhet se është jashtë ligjeve, ose nuk i përshtatet ligjeve në fuqi. Argumenti të cilin e dha kryetari, po më duket shumë i cekët dhe i zbehtë, se me deklarata na s’un veprojmë, kryetar. Ne nuk po i besojmë një institucioni që është Ministria, cilado qoftë ajo, po i besojmë një deklaratë të ish-drejtorit. Po më duket shumë e ulët kjo. Unë po besoj që është mirë na me e shfuqizue, përderisa na është kthyer nga një institucion koxha i një rëndësie të veçantë. Faleminderit shumë!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Uran! Fjalën e ka Shpetim Hajredini.

**Shpetim Hajredini:** Përshëndetje edhe një herë për të gjithë! Kryetar, qaj dokumenti që e dhaje ti si arsyetim, sa ta merr mendja ty që e bind Ministrinë tash, se vendimi që po kërkon ta marrim tash për këto toka që është në rregull? Nëse ta kanë kthye Ministria si të paligjshëm edhe vendimin që ne e kemi marrë ma herët dhe ta kanë dhënë arsyetimin e tyre, dhe tash ti e prune këtu një dokument, kush ka qenë ky person, ish-drejtor a çka ka qenë, ta ka dhënë deklaratën, mirëpo sa ta merr si valide dhe si

reale Ministria tash? Na mundim prapë me e votue edhe na kthen prapë mbrapsht atë. E, t'i sqarojmë mirë tash edhe arsyetimin ta kemi na në material. Unë nuk e di, qetu e kqyra, s'po muj me e gjet qetu, veç parcelat po m'i jep qeky telefoni. Okej, krejt në rregull edhe nëse e keni dërgue, ka mundësi mu më paska tejkalue ky vendim të cilin e ka marrë Ministria, por sa do ta marrin tash si reale dhe si argument, që i bind ata që këto toka nuk i takojnë 'Sharrprodhimit'? Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Shpetim! Agron Gashi e ka fjalën.

**Agron Gashi:** Pajtohem me kolegun që tha paraprakisht se nuk është e mjaftueshme nga drejtori paraprak i cili i ka dhënë rekomandimet e veta, është apo s'është. Këtu kemi procedurë ligjore administrative të cilat figurojnë në gjeodezinë apo Kadastrin e Komunës. Por, ne duhet të kemi parasysh se incizimet e fundit të vitit 1981, kanë pasur lëshime të shumta në evidentim të parcelave të cilat kanë qenë. Por, do të ishte një rekomandim, një sugjerim i imi personal, më mirë do të ishte që edhe në vitet '51-ta, kur kanë qenë incizimet para '81-tës, të bëhet një hulumtim më adekuat, që të jetë ligjor, dhe të shihet se kujt i takon ajo parcelë, ngase përmes këtij drejtori, pajtohem me kolegun paraprak, nuk janë të mjaftueshme. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Agron! Fjalën e ka Uran Halimi.

**Uran Halimi:** Përshëndetje edhe njëherë! Sa për informacion, gjatë trajnimeve, takimeve që kemi pas me MAPL-në, unë vazhdimisht kam bërë kërkesë, kryetar, kam pyet çka nëse një vendim që kthehet mbrapsht, Kuvendi e lë ende në fuqi. Bile, njëri prej tyre është takimi i fundit që e kam pas me MAPL-në. Nëse MAPL-ja bën kërkesë që me u kthye një vendim mbrapsht ose me u rishqyrtue, nëse na nuk bashkangjesim argumente të duhura, rrezikon Komuna si institucion me shkue në gjyq. Automatikisht, na si Komunë, jo ti kryetar, as një individ këtu i përveçëm, po Komuna si institucion, kryetar, rrezikon me u padit, automatikisht paditet Komuna. Nëse je i interesum që na me e hup edhe një padi, atëherë edhe mundim me e lënë në fuqi. Por unë besoj që gjithmonë vendimet që kthehen mbrapsht, është mirë na me i kthye në pikën zero, aty ku kanë qenë. Faleminderit shumë!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Uran! Fjalën e ka kryetari, z.Bexhet Xheladini.

**Bexhet Xheladini:** Dëgjo, ne e 10 vjet jemi duke u gjykue me AKP-në për pronat që na i ka marrë, për me i rikthye, e është një pronë këtu që është NN, e askujt, edhe ne vetë po luftojmë, po dona atë pronë me ia lënë prapë AKP-së ose 'Sharrprodhimit', kur ajo është e regjistrueme NN, është e askujt. Është pronë në tokën tonë, në Komunën tonë, në zonën kadastrale 'Pllava 2'. Edhe nuk është e vërtetë që vendimi na u kthye i jashtëligjshëm, na u kthye me e rishqyrtue. Me pas ardhë vendimi i jashtëligjshëm, na nuk e kishim qit. Na kemi të drejtë ligjore, unë ju garantoj që nuk ka reperkusione ligjore aspak. Nëse na edhe një herë e provojmë me këtë argumentin, se ata e kanë marrë që ish-drejtori i 'Sharrprodhimit' ka deklarue që kjo pronë ka qenë e 'Sharrprodhimit'. Ne deklaraten e kemi të protokolluar, e provojmë, pse mos me e kthye atë tokë e cila nuk është e askujt, pronë të Komunës. Unë

si kryetar i Komunës jam i obliguar me jua dhënë këto shpjegime, ju nëse doni atë pronë me ia lënë dikujt tjetër...por, prapë Ministria ka me e rishqyrtue edhe ka me e pru vendimin definitiv. Ka me e pru si vendim të ligjshëm ose të jashtëligjshëm. Nëse vjen vendimi i jashtëligjshëm, ne e anulojmë atë edhe nuk ka kurrfarë të keqe.

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.kryetar! Është paraqitur z.Nexhat Selaj. Urdhëro!

**Nexhat Selaj:** Përshëndetje edhe një herë! Kryetar, po më duket se po na gjuajsh topin, nëse doni ju. Përderisa ju i keni ekspertët ligjorë, keni emërue ekspertë ligjorë. I ke ekspertët ligjorë, le ta hulumtojnë ata, a është e drejtë apo jo tani na servoni neve. Nuk jemi ne kundër që një pjesë e Komunës të jetë – 10 hektarë apo sa ishte ajo – të mbete anonime, e askujt, ose ta marrë ndonjë kompani tjetër. Ne jemi për atë që të kalojë, por sa është valide, edhe një herë, kur t'i shterni të gjitha rezervat me juristët edhe na bjer neve të gatshëm, ne do të jemi pro, nuk do të jemi kundër asaj. Këtu shtrohet pyetja, jo a dëshironi ju apo nuk dëshironi. Ne jemi për po, kush thotë që jo? Por në bazë të këtij dokumenti, na vjen i hamendur që ne të votojmë tash, pas një kohe të na kthehet prapë edhe një herë kundër. Që të mos votojmë ne disa herë – nuk është hera e parë, disa herë po na kthehen vendimet mbrapsht, në mungesë të profesionalizmit juridik, me të cilët ju po merreni me të gjitha këto. Saktësoje mirë, bjere në Kuvend, ne do të jemi pro. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Nexhat! Unë mendoj se kryetari ishte shumë i qartë, dha shpjegime rreth kësaj çështjeje. Kontesuese ishte çështja që ato ende llogariten si pronë e 'Sharrprodhimit', sipas Ministrisë, veç ato janë NN, siç tha kryetari. Edhe ne si asambleistë duhet të mbrojmë interesin e Komunës dhe kjo pronë të kthehet në pronësi të Komunës. Jo vetëm këto, por të gjejmë zgjidhje edhe për pronat tjera. Fjalën e ka kërkue z.Nedžmidin Sejdlar.

**Nedžmidin Sejdlar:** I dëgjova me vëmendje të gjithë të pranishmit dhe dola në përfundimin, do të jeni ju ai që do të jeni në bankën e të akuzuarve, unë personalisht nuk dua t'ju shoh atje. Në këtë drejtim ju këshilloj nëse nuk jeni të sigurt dhe e dimë që kjo komunë nuk ka avokatë cilësorë që kanë fituar qoftë edhe një gjykim deri më tani. Ju këshilloj ta shqyrtoni më thellë këtë çështje, të konsultoheni me të tjerët dhe të na sillni një propozim për ta votuar në kuvend. Sa për mua personalisht, jam pro çdo gjëje që votohet për interesa të qytetarëve. Keni te drejte, duhet te kthehet prona komunale qe eshte ne prone te komunës qe qytetaret te shohin ndonje hajr ne ate prone, e jo Agjencia e Privatizimit ta nxjerre ne tender dhe te vije ndonje bos apo biznesmeni te krijoje problem për qytetarët. Duke qenë se është koha e Xhumasë, kërkojmë pushim.

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Nedžmidin! Fjalën e ka kryetari.

**Bexhet Xheladini:** Kjo deklaratë është e protokolluar, është zyrtare, ka një numër të protokollit, ka datë, me numër të protokollit me të gjitha. Edhe unë, nëse ka nevojë, për pronën komunale shkoj edhe në gjyq. Ju, disa prej asambleistëve, keni pru vendim që pronën e cila ka qenë në pronësi të

‘Sharrprodhimit’ e keni bart në Kadastër, e keni qit si pronë komunale. Edhe për atë ju keni qenë në gjykatë, për atë jemi edhe në gjykatë pse është bërë ky proces. Ne nuk pi biem vendim këtu në Asamble Komunale që tash ne me e urdhëruë Kadastrin edhe me e bart pronën nga NN me e qit në tokë të Komunës. Po ne po e biem një vendim, po e çojmë vendimin në Ministri, me e rishqyrtue ata vendimin. Nëse ata e bien të jashtëligjshëm, ne në mbledhjen e ardhshme e anulojmë. Nuk ka kohë me e shty, për arsye se na me ligj brenda muajit është dashtë me rishqyrute, mirëpo pasi që mbledhja e kaluar nuk ka prodhuar efekte juridike, sikurse mos me u pas mbajjt, atëherë na jemi të obliguar sot me e krye këtë punë. Edhe unë e di që për këtë në gjykatë nuk shkohet, sepse na kanë çue me e rishqyrtue. Me pas pru vendimin të jashtëligjshëm, ne do ta anulonim. Adem, nëse ke diçka ti me sqarue?

**Adem Emimi:** E njëjta kërkesë i ka shkue edhe Ministrisë, ajo ka thënë që sipas deklaratës së ish-drejtorit këto prona kanë qenë në emër të ‘Sharrprodhimit’. A në fakt, në deklaratë shkruan që këto prona nuk kanë qenë asnjëherë të ‘Sharrprodhimit’, edhe për atë arsye po e qesim në rishqyrtim.

**Bexhet Xheladini:** Ne vendimit do t’ia bashkëngjesim këtë deklaratë.

**Mehmet Spahiu:** Fjalën e ka Samidin Xheladini.

**Samidin Xheladini:** Të nderuar të pranishëm! Ju përsëndes të gjithëve! U kënaqa prej opozitës, që më la përshtypje edhe me erdhi shumë mirë. Ju opozita s’po doni vëllaun me ma çue në burg, ai po do vetë me shkue. Në të kaluarën edhe na kemi votue kështu. I kemi dhënë mbështetje edhe Salimit edhe Lulzim Rifajt, e kemi mbështet fuqishëm, me 27 vota, pronën e Komunës me e kthye, se na kanë marrë pa të drejtë. Në vitet ’70-ta, ka qenë Behadin Ahmetoviçi atëherë, ka qenë sistemi jugosllav – komunist. Komuna ia ka dhënë në shfrytëzim pronën komunale ‘Sharrprodhimit’. Tash, pas luftës, pronat që i ka pas në shfrytëzim, i ka marrë AKP-ja, edhe na i ka marrë pa të drejtë. Ky është një vendim jo i drejtë, po tash është në fuqi. Na duhet me bo çmos edhe e kemi mbështet në mënyrë permanente Salim Jonuzin edhe Lulzim Rifajn, që kanë pas aktakuzë. Edhe me shkue në burg për diçka që është në të mirën e qytetarëve ia vlen. Edhe po më vjen mirë që kryetari është i gatshëm me shkue në burg.

**Bexhet Xheladini:** Faleminderit, z.Samidin! Agron Gashi e ka fjalën.

**Agron Gashi:** Nëse bëjmë një analizë pak më të thjeshtë, nëse kjo pronësi, tokë, gjendet në AKP, dhe do ta çojë në likuidim AKP-ja, edhe këtë parcelë do ta çojë në likuidim. A do të ishte më mirë që në organet gjegjëse të AKP-së, se çfarë do të bëjë më tej lidhur me këtë parcelë e cila ka mbetur diskutabile. Do të ishte shumë më mirë të kërkohet sqarimi nga ajo, dhe derisa ajo tash e ka marrë nën menaxhim, ato në vitet ’70-ta kanë qenë në pronësi komunale, ku merren dhe ka të drejtë në pronësi AKP-ja. Derisa AKP-ja është përgjegjëse për likuidimin e parcelave të tilla, atëherë do të ishte mirë që neve si Komunë të adresojmë një kërkesë dhe të na japë rekomandime dhe sqarime se çfarë duhet të bëjmë ne me këtë parcelë e cila nga ngelur e padefinuar. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Agron! Shpetim Hajredini e ka fjalën.

**Shpetim Hajredini:** I nderuar kryetar, ti e dish që vendimin që e ke marrë ne fillim, më 24.04.2023, propozimin e parë për bartjen e këtyre pronave në pronësi komunale, ne e kemi mbështet të gjithë, edhe sot do ta mbështesim. Por unë të thashë, sa do ta bind Ministrinë ky argument i juaji. Këtë deshta ta di unë, pasi që në vendim të kthimit të propozimit të kaluar ne nuk e kemi. Unë nuk e tash, ti vetëm po na tregon gojarisht, që ka kërkue rishqyrtim po thuesh. Unë s'e kam pa Ministria çka ka kërkue. Në vendimet e ardhshme, ju lutem na i bini edhe propozimet apo gjetjet ku i ka bo Ministria dhe çka kërkojnë prej Komunës, që ta dimë pastaj a ta votojmë apo jo. Se na e votojmë sot, na kthen pas dy javëve prapë Ministria, atëherë s'kena bo kurgjo na. Dalim shumë keq. Përndryshe, unë absolutisht s'jam kundër. Por është mirë, bile në vendimet e ardhshme të na bini arsyetimin, pse është duke u kthyer nga Ministria një vendim i tillë. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Shpetim! Mbyllet diskutimi! Hedhim në votim pikën e katërt të rendit të ditës. Kush është pro kësaj pike? Kundër? Abstenim? Me 23 vota pro, 3 vota kundër dhe asnjë abstenim, miratohet miratohet pika e katërt e rendit të ditës. Nedžmidin Sejdilar e dha një propozim shumë të mirë, që ta ndërprejmë tash. Nëse pajtoheni, e kemi edhe një pikë, nuk besoj që ka diskutime rreth kësaj: Miratimi i Planit të Punës të KKSB-së për vitin 2024.

**Nedžmidin Sejdilar:** Zoti Kryesues, mendoj se pika e radhës është shumë serioze dhe nuk mund ta kalojme kështu. Kjo është arsyeja pse unë do të doja t'ju kërkoja ta lini për pikën tjetër të rendit të ditës për të shqyrtuar detajisht dhe për të bërë punë cilësore. Duket sikur po ushtroni një lloj presioni mbi delegatët për t'i kaluar sa më shpejt këto pika. Le ta lëmë këtë pyetje pas pushimit.

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit! Pajtohem me propozimin e z.Nedžmidin Sejdilar. Një pauzë deri në ora 13:15.

Te nderuar asambleiste dhe asambleistë, vazhdojmë me seancën e dhjetë. Në radhë e kemi pikën e pestë të rendit të ditës: Miratimi i Planit të Punës të KKSB-së për vitin 2024. Dëshiron dikush të marrë fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës? Fjalën e ka kryetari i Komunës, z.Bexhet Xheladini.

**Bexhet Xheladini:** Të nderuar asambleistë, një prej pikave të rendit të ditës edhe miratimi i Planit të Punës të KKSB-së për vitin 2024. Është obligim ligjor që KKSB-ja, gjegjësisht kryetari i Komunës të përgatit planin vjetor të punës të këtij mekanizmi. Ju e keni marrë Planin vjetor të Punës. Ky plan parasheh që brenda vitit KKSB-ja të mbajë së paku gjashtë takime. Në çdo takim janë të parapara pikat e rendit të ditës që duhet të diskutohen. Gjithashtu, duhet të ju njoftoj që, pas një analize njëvjeçare të punës së KKSB-së në nivel të Kosovës, jemi rendit si një ndër KKSB-të më të suksesshme, jemi në tri vendet e para, si mekanizëm i cili i ka mbajtur të gjitha takimet. Konkluzionet që janë arrit në atë takim i kemi zbatue në praktikë. Andaj, i ftoj asambleistët që pas diskutimit që do të kenë, pas propozimeve nëse ka nevojë, pas plotësimeve, ta miratojmë Planin e Punës të KKSB-së për vitin 2024. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.kryetar! Dëshiron që të marrë fjalën ndonjëri prej asambleistëve? Siç

po duket nuk ka të interesuar për me e marrë fjalën. Atëherë, e hedhim në votim pikën e pestë të rendit të ditës. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Me 13 vota pro, zero kundër dhe 11 abstenim, miratohet miratohet Plani i Punës i KKSB-së për vitin 2024. Pika e gjashtë është hequr. Kalojmë në pikën e shtatë: Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Të nderuar të pranishëm, më duhet të jap një shpjegim për mënyrën e zgjedhjes së kryesuesit. Të gjitha subjektet politike, kandidatët e pavarur apo nismat qytetare, kanë të drejtë të propozojnë kandidat për kryesues të Asamblesë. Ftoj subjektet politike që të bëjnë propozimet për kandidat të mundshëm. Fjalën e ka z.Naser Myrtezani.

**Naser Myrtezani:** Faleminderit, i nderuar udhëheqës i seancës! I nderuar kryetar i Komunës, të nderuar kolege dhe kolegë asambleistë! Ne si grup parlamentar dhe si qeveri komunale, që e përfaqësojmë këtë grup të Asamblesë Komunale, propozojmë znj. Arijeta Qafleshi Skeraj si kandidate për kryesuese të Asamblesë Komunale. Nëse më lejohet, një biografi të shkurtë.

*znj.Arijeta Skeraj u lind më 24.04.1978 në fshatin Bellobrad, ku shkollën fillore e kreu në Bellobrad, të mesmen në Bresanë, gjenerata e parë e mjekësisë së përgjithshme, Fakultetin e Infermierisë e kreu në Prishtinë. Në vitin 1997, Arijeta filloi të punojë si infermiere në Qendrën 'Nënë Tereza' afër dy vite në fshatin e lindjes. Në vitin 1999 ka punuar në Shqipëri gjatë kohës së luftës në Kryqin e Kuq të Finlandës. Nga viti 2000 deri në 2003, punoi në Dragash në OSCE, si zyrtare për regjistrimin e popullsisë. Në vitin 2003 Arijeta Skeraj punësohet në Spitalin Regjional të Prizrenit 'Daut Mustafa' kurse 20 vite punon në mjekim intenziv qendror. Në vitin 2007 për herë të parë znj.Skeraj i hyn garës për Asamble Komunale, ku del femra më e votuar në Komunë për dy mandate. Ndërsa në katër mandate, femra më e votuar në radhët e LDK-së. Që 8 vite është kryetare e Forumit të Gruas në Dragash. Gjatë këtyre mandateve ka të kryer katër akademi për qeverisje. Gjithashtu, është anëtare e Lobit për Barazi Gjinore. Vjen nga një familje e shkolluar. Qafleshi është e martuar me Bexhet Skeraj, është nënë e katë fëmijëve, tri vajzave dhe një djali.*

Atëherë, të nderuar kolege e kolegë, ju ftoj të gjithëve pa dallim, që ta votoni, ta votojmë në tërësi zonjën e nderuar, e cila ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm, edhe në Kuvend edhe jashtë Kuvendit, në të gjitha sferat. Ju falemnderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Naser! Ftoj subjektet tjera politike, nëse dëshirojnë të propozojnë ndonjë kandidat të mundshëm! Fjalën e ka Shpetim Hajredini.

**Shpetim Hajredini:** Ju falemnderit për mundësinë! Unë si shef i Grupit të PDK-së, nuk kam propozim për kryesues. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Shpetim! Subjektet tjera? Nëse nuk ka, atëherë konstatojmë se kemi vetëm një kandidat për kryesuese të Asamblesë, Arijeta Skeraj. Tash në bazë të Rregullores 2009/1, duhet ta formojmë Komisionin për mbarëvajtjen e procesit të zgjedhjes së kryesuesit. Anëtarë të mundshëm duhet të jenë tre ose pesë. Përcaktohem për pesë, me qëllim që të kenë qasje të gjitha

subjektet politike. Ftoj subjektet politike që të propozojnë kandidatët e mundshëm të Komisionit.

**Naser Myrtezani:** Unë e propozoj veten time.

**Shpetim Hajredini:** Ne jemi Grupi më i madh dhe fjala duhet të na jepet neve të parëve, por s'ka rëndësi. Atëherë ne e propozojmë z.Driton Ademi.

**Miralem Rahte:** Po propozohem para partisë SDU.

**Munir Jonuzi:** Të nderuar, kolegu përmendi një subjekt politik që nuk ishte në zgjedhjet e 2021 dhe ai nuk ka të drejtë të propozojë një kandidat këtu. Nëse dikush ndryshon parti, ju kërkoj të udhëhiqeni nga kjo listë dhe të mos e merrni parasysh këtë propozim. Përballë koalicionit Vakat propozoj veten.

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Munir! Domethënë kandidat është Munir Jonuzi. Ndërkaq, Miralemi, sipas Munirit, nuk ka të drejtë të propozojë kandidat, nëse nuk është i certifikuar si subjekt politik. Fjalën e ka Miralemi prapë.

**Miralem Rahte:** Meqë Muniri thotë se ne kemi ndërruar parti, ne kemi ndërruar parti, dhe partia jonë aktuale është SDU, do ta pyesja Munirin, pasi nuk i di aq shumë ligjet, nëse nuk kemi të drejtë, të më thotë sipas të cilit ligj nuk e kemi atë të drejtë. Faleminderit.

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Miralem!

**Munir Jonuzi:** Zoti Rahte, po ju flas në bazë të ligjit për zgjedhjet dhe verifikimit të mandatit të komisionit qendror të zgjedhjeve. Ne të gjithë përfaqësojmë një subjekt politik këtu, pavarësisht se si do të veprojmë më vonë, ne jemi zgjedhur përballë një subjekti politik. Këtu janë të gjitha subjektet tona politike mbi bazën e të cilave kemi marrë mandatet tona. Partia SDU nuk është në këtë listë. Në vitin 2025, kur të jesh në atë listë zgjedhore dhe të fitosh mandatin, atëherë do të mund të përfaqësosh SDU-në dhe të bësh propozime këtu në emër të SDU-së. Përpiqem të flas ngadalë për shkak të përthimit. Nëse i lejojmë përfaqësuesit e partive politike këtu, nesër të gjithë mund të ndihen si përfaqësues të ndonjë subjekti politik, por nuk mund ta përfaqësojnë këtu përderisa kjo listë është këtu me këto parti politike. Z. Rahte nuk ka të drejtë të propozojë në emër të një partie që nuk është në këtë listë.

**Mehmet Spahiu:** Fjalën e ka z.Uran Halimi.

**Uran Halimi:** Përrshëndetje, të nderuar delegatë! Sa i përket këtu listës, unë po e shoh që z.Rahte dhe Merunisa Brenoli janë anëtarë të VAKAT. Domethënë, ata duhet me u zgjedhë komisionerë në bazë të subjektit që i takojnë. Këtu tash ose u dashtë me e ndërrue Zyra e Kuvendit subjektin politik – te na në Dragash CDU-ja s'ka kandidue. Për shembull, e kemi edhe rastin te znj.Pajtesa, kësaj ia kanë ndërrue. Kështu që, me siguri është ndonjë gabim këtu në listë, në midis kësaj punës është njëfarë konflikti. Ata kanë hy në garë si VAKAT, tash janë CDU, i bjer që edhe Pajtesa s'ka të drejtë nëse është puna me u zgjedhë si kandidate për Komision këtu për përzgjedhjen e kryesuesit, i bjer që Pajtesa s'duhet me u zgjedhë a po? Se është e VV-së, sepse votat i ka marrë si VV. Tash, është njëfarë konflikti këtu.

**Munir Jonuzi:** Nëse e lejojmë Miralemin të bëjë propozime në emër të partisë që nuk ka qenë në zgjedhje, atëherë duhet të lejojmë që Pajtesa Berisha të bëjë propozime në emër të VV-së. A jeni dakord me një deklaratë të tillë? Sigurisht që jo. Ajo u zgjodh në listën e VV-së, nuk mund të parashikoni se cili do të jetë aktiviteti i saj politik, as ne nga Vakat nuk mund të parashikonim se cili do të jetë aktiviteti politik i Miralema Rahtës. Ai ndërroi anë, kjo është e drejta e tij. Fatkeqësisht, ligji thotë se janë mandatar, por e drejta e tyre morale është të japin dorëheqje sepse nuk janë përballë subjektit politik të SDU-së. Me këtë kërkoj publikisht që të japin dorëheqjen si delegatë për shkak se u janë dhënë mandate para një subjekti politik të cilit nuk i përkasin.

**Uran Halimi:** Të nderum delegatë, nëse është kështu, unë e lus Zyrën e Kuvendit që kandidatëve që po pretendojnë se janë CDU, le t'ia qesin edhe subjektin politik këtu CDU. Na katër delegatë i paskemi atëherë, a? Nuk duhet me u zgjedhë, a po? Në emër të VV-së. Pajtesa e ka edhe Komitetin për Komunitete në emër të LVV-së. Çka po di, tash duhet me e dhënë mandatin nëse është VV dhe e voton LDK-në. Kjo nuk pasqyron interesat e subjektit tonë. Duhet me i zgjidhë këto probleme, ndërronja emrin aty, ju lutem!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Uran! Fjalën e ka Munir Jonuzi.

**Munir Jonuzi:**

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit! Fjalën e ka Miralemi.

**Miralem Rahte:** Ju kërkova të më tregoni sipas cilit Ligj, jo sipas ndonjë liste. Në atë listë, diçka mund të jetë futur gabimisht. Unë nuk jam dakord me këtë, po pyes sipas cilit ligj. Dhe faktin që ne thamë të kthejmë mandatet, mandatet na i ka dhënë populli. Fotografia ime ishte në atë listë dhe njerëzit votuan për mua. Dhe falë atyre njerëzve që më votuan, mandati dhe karrigia juaj është falë meje. Sepse votat e mia shkuan direkt për ju. Pra, para se të më kërkoni të jap dorëheqjen, duhet të dorëzoni vetë dorëheqjen tuaj. Edhe një herë kërkoj një nen të ligjit që nuk kam të drejtë ta propozoj para partisë SDU.

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Miralem! Fjalën e ka Nedžmidin Sejdilar.

**Nedžmidin Sejdilar:** Të nderuar qytetarë, e shihni se çdo gjë është e mundur në politikë, është hera e parë që dëgjoj që dikush mund të fitojë një mandat në bazë të një fotoje. Siç tha Miralem se ka marrë mandate në bazë të fotos, do të thotë që ne hamë mish nga viçi në foto e konzervës? Po mundohem t'i kuptoj gjërat. Nuk e dija që Rahte donte aq shumë të bëhej anëtar i atij komisioni, por nëse do, do ta propozoj, por në emër të listës Srpska. Para kësaj le ta pyesë Rakiqin nëse do të lejohet të jetë anëtar. Nëse zotërinj kandidojnë për SDU, parti që nuk ka marrë pjesë në zgjedhjet lokale, duhet të

përrjashtohen nga komisionet. Bilanci i komisioneve nuk është ai që donin qytetarët. Të gjithë kemi fituar mandate në lista të hapura, por komisionet janë formuar sipas përmasave partiake. Çfarë kërkojnë në ato komisione ata të SDU-së nëse ajo parti nuk ekziston në këtë parlament. Mund të mbajnë mandatet, mund të quhen edhe marsianë, kjo është e drejta e tyre, por nuk mund të jenë anëtarë të komisioneve. Formula për pjesëmarrjen në komisione shpërndahet në bazë të numrit të votave që ka fituar partia.

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Nedžmidin! Më falni vetëm pak! Propozimin që e dha ti, ta propozosh Miralemin në emër të Listës Serbe, është një propozim denigrues. Ne subjekt të tillë nuk kemi në Komunën e Dragashit. Ti nëse dëshiron ta propozosh Miralemin, ke mundësi ta propozosh në emër të ndonjë subjekti tjetër që janë përfaqësuese në Kuvendin Komunal të Dragashit. Të kesh kujdes herave të tjera! Një minutë replikë ka, po mos ta përmendësh Listën Serbe, se nuk ekziston si subjekt politik.

**Nedžmidin Sejdlar:** Zoti Kryesues, këtu jam dakord me ju, pranojmë kritikën tuaj. Lista serbe nuk ekziston në komunën e Dragashit e as SDU-ja. Atëherë le ta propozojmë atë në emër të marsianëve.

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Nedžmidin! Unë besoj se nuk ka nevojë shumë të merremi me këtë çështje, se kemi pesë anëtarë. Më falni vetëm pak! Po jua jap një shpjegim, prapë ju do e merrni fjalën. Kemi pesë anëtarë, meqenëse CDU-ja s'po ekzistojka, ne mund të mos e futim në listë Miralemin, mbeten edhe katër anëtarë të tjerë. Nuk prish punë ajo. Por, edhe nëse është Miralemi, aty janë pesë anëtarë, me shumicë votash miratohet çdo vendim aty. Po them si solucion i mundshëm, jo që po e propozoj unë. Kush dëshiron të marrë fjalën? Urdhëro, z.Nexhat Selaj.

**Nexhat Selaj:** Përrshëndetje edhe një herë! Doktor, nëse kem durim pak! Doktor, nëse ke durim pak me dëgjue! Faleminderit, edhe një herë faleminderit për kolegët! Në fillim, kryesues, m'u doke si shumë i prerë edhe mendova se do ta vazhdoj prej fillimit kështu, por po doket se nuk ke konduksion për udhëheqje. Unë nuk po muj me e kuptu, a është fontanë dëshirash kjo foltore, apo jo? Ne e kemi zyrtarin ligjor para vetes. Si parti, si CDU, as nuk ka figurë. Vota janë marrë në emër të një partisë tjetër. Si ka ky të drejtë tash të propozohet në Komision? Nëse ju dëshironi që t'i plotësoni dëshirën atij, shumë lehtë e keni, edhe pse është një anëtar, zgjidhne edhe një të CDU-së bre, bini dy. Këtu janë duke na dëgjue, janë duke na përcjellë njerëzit të cilët na vlerësojnë, edhe ne jemi për me u vlerësue, se kemi ardhë nga qytetarët. Mos të lejojmë këtë foltoren ta shndërrojmë në fontanë dëshirash. E ke zyrtarin ligjor, konsultohu me zyrtarin ligjor, nëse lejohet mirë, nëse jo edhe ma mirë, vazhdojmë me pikat tjera të rendit të ditës. Tan ditën e lume për një anëtar, a ka të drejtë a s'ka të drejtë.

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Nexhat! Dëshiron të marrë fjalën Miralemi prapë?

**Miralem Rahte:** Nëse tashmë ndiheni kështu dhe nëse është më e lehtë për ju, këtu ju propozoj Miralem Rahten nga partia Vakati, Miralem Rahten aktualisht nga partia SDU.

**Mehmet Spahiu:** Fjalën e ka Jetmir Ajdini.

**Jetmir Ajdini:** Përhëndetje për të gjithë! Kryesues, ju kërkoj edhe një herë që të respektohet pak rendi dhe rregulli i Kuvendit Komunal. Të shkohet me rend, qysh e kanë kërkuar anëtarët fjalën. Nuk ka kurgjo të keqe nëse unë e kam kërkuar fjalën me dalë me folë këtu. Për atë jemi dhe për atë punë jemi zgjedhë. Këshillë për tjera herë! Nuk është problem që s'ma dhaje fjalën. Edhe një herë, Kuvendi Komunal i Dragashit nuk është këtu fontanë dëshirash edhe me dalë kujt çka t'i tekton me propozue. Nuk mund një anëtar i Kuvendit Komunal të Dragashit të propozohet nga një subjekt i cili është inekzistent në Kuvendin e Dragashit, edhe të dalë të propozojë këtu veten në emër të një subjekti... ti mundesh t'i përkasësh cilitdo subjekt që ti ke qef, po këtu në Kuvend Komunal të Dragashit nga votat e VAKAT-it, nuk je nga votat e CDU-së. Nuk ke marrë pjesë në zgjedhje hiç si CDU. Kështu që, nuk është Kuvendi Komunal i Dragashit për hajgare. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Jetmir! Fjalën e ka z.Edin Kurt.

**Edin Kurt:** Përhëndetje të gjithëve meqenese lista e JGP mori pjese ne zgjedhje propozoj Ventaza Esati.

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Edin! Fjalën e ka Agroni.

**Agron Gashi:** Atëherë, ju përhëndes edhe një herë! U krijuan dilema se si duhet të formohet ky Komision. z.Kryesues, së bashku me zyrtarin ligjor, ka nevojë ky Kuvend që edhe një herë ta sqarojë nga kush të përbëhet ky Komision. Nga partitë politike, apo kanë të drejtën edhe çdo anëtar që ka legjitimitet dhe sovranitet të popullatës me votat që kanë marrë. Në një situatë të tillë, unë po konsideroj se çdo anëtar ka të drejtën e propozimit të kolegës dhe fare pak ka rëndësi subjekti politik. Dhe, unë po kërkoj nga ju edhe një herë, nga këta asambleistë që u krijua kjo përplasje dhe rrëmujë, si duhet të formohet ky Komision? Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Agron! Meqenëse u kërkuar z.Miralem Rahte të mos jetë kandidat, na mbeten vetëm katër kandidatë këtu. Edhe një kandidat duhet të propozohet nga ndonjë subjekt. Nedžmidin Sejdilar e ka kërkuar fjalën.

**Nedžmidin Sejdilar:** Më vjen shumë keq që duhet t'ju korrigjoj por gabimisht formoj komisionin. Një komision prej pesë anëtarësh formohet në bazë të pesë grupeve më të mëdha parlamentare. Që do të thotë që ju si kryetar i këtij kuvendi fillimisht duhet të ftoni grupin e parë parlamentar më të madh si PDK-në, LDK-në, VV-në, Vakatin e kështu me radhë sa të mundeni dhe jo si në treg ku të gjithë ngrihen dhe. sugjeron të gjithë.

**Mehmet Spahiu:** Shumë faleminderit, z.Nedžmidin Sejdilar, për këshillën që ma dhe! Me sa duket dhe me sa keni dëgjuar, unë i pyeta grupet parlamentare të propozojnë kandidatët e mundshëm. Nuk ia përcaktova asnjë subjekti politik se kënd ta propozojnë. Për fjalë u paraqit nga LDK-ja Naser Myrtezani, detyrimisht mu më duhet të ia jap fjalën. Në momentin kur PDK-ja vendosi të paraqesë kandidaturën, ose propozoi kandidatin, unë ia dhashë fjalën. Unë nuk di çfarë shkelje ligjore është bërë këtu. Se PDK-

ja nuk dëshiroi të marrë fjalën fillimisht, unë s'mund t'i detyrojë anëtarët e PDK-së të marrin fjalën. Është çështje e tyre kjo. Vazhdojmë me seancën, me pikën e rendit të ditës. Na duhet edhe një propozim për një kandidat të mundshëm për Komisionin për mbarëvajtjen e ecurisë së zgjedhjes së kryesuesit. Fjalën e ka z.Samidin Xheladini.

**Samidin Xheladini:** Unë e propozoj Agron Gashin nga AAK. Unë kam të drejtë me propozue.

**Mehmet Spahiu:** Pyes z.Agron, a e pranoni propozimin e z.Samidin Xheladini?

**Agron Gashi:** Unë pak më parë dola në foltore. Po të kisha pasur një koleg tjetër, patjetër se do ta kisha propozuar, por nuk e pashë të arsyeshme ta propozoj vetveten, kështu që faleminderit z.Samidin Xheladini!

**Mehmet Spahiu:** Tash, ftoj anëtarët e Komisionit për mbarëvajtjen e zgjedhjes së kryesuesit që të takohen tek zyra e Kuvendit, ndërsa ne për dhjetë minuta marrim pauzë. Pas dhjetë minutave vazhdojmë me seancën!

*(Votimi i asambleistëve për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës)*

**Driton Ademi:** Atëherë, prej 26 delegatëve sa janë pjesëmarrës në sallën e Kuvendit, kanë marrë pjesë në votim 23 dhe 3 nuk kanë marrë pjesë. Tash po i njehim votat dhe dalim me rezultatet.

*(Numërimi i votave)*

**Driton Ademi:** Atëherë, të nderuar kolegë! Nga **26** anëtarë të Kuvendit, pjesëmarrës në sallë, **23** kanë marrë pjesë, **3** nuk kanë marrë pjesë. **19** vota janë **pro**, **4 kundër**. Urime, suksese Arijeta! Atëherë, ftoj Arijeta Skerajn për një fjalë rasti!

**Arijeta Qafleshi Skeraj:** Përshëndetje të gjithë anëtarëve dhe kolegëve të mi! Faleminderit që ma besuat këtë! Unë po ndihem jashtëzakonisht e lumtur që e kam marrë këtë detyrë. Besoj që do ta kryejë bashkërisht me ju dhe do t'ia dalë. Dua ta falënderoj për dy vite që ka qenë një punë shumë e mirë në Asamble. Do të bashkëpunoj shumë ngushtë me kryetarin e Komunës për t'i qit pikat e rendit të ditës. Unë nuk dua që në këtë sallë të falënderoj shumë njerëz, por do të ma lejoni, nuk po e bëj politike. Unë prej moshës 19-vjeçare jam rrit në LDK, dhe besimin ata dje që ma kanë dhënë 99%, do të jam mirënjohëse pa fund. Kjo ditë, që për mua është ndër ditët më të mira dhe, ndoshta, është edhe fundi i karrierës sime, por jam shumë e lumtur dhe shumë e gëzuar që edhe opozita më ka mbështet jashtëzakonisht shumë. Që 16 vite në Asamble këtu, asnjëherë nuk ka marrë pjesë asnjë familjar i imi, por sot është për herë të parë që merr qika pjesë dhe jam shumë e lumtur. Faleminderit shumë!

**Mehmet Spahiu:** Në emër të Kuvendit Komunal, edhe unë i uroj Arijetës për zgjedhjen kryesuese të Kuvendit Komunal, me dëshirën që të jetë e të gjithëve dhe për të gjithë! Urime edhe një herë, Arijetë! Vazhdojmë me seancën, është pika eventuale. Meqenëse Suada Bajrami e paraqiti një çështje, ftoj Suadën që ta marrë fjalën në pikën eventuale.

**Suada Bajrami:** Përshëndetje për të gjithë! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe në emër të Grupit të Grave, fillimisht uroj Arijetën si kryesuese e parë femër! I urojmë fat dhe suksese në punë! Ne si Grup i Grave Asambleiste, gjatë këtij mandati kemi punuar për nevojat për gratë dhe vajzat në komunitetin tonë, së bashku me OSCE-në. Gjatë punëtorisë që kemi mbajtur më datën 12 dhe 13 shtator, të organizuar nga OSCE-ja, ku pjesëtarë ishin Grupi i Grave, zyrtarja për Barazi Gjinore dhe kryetari i Komunës, jemi munduar që t'i paraqesim disa prioritete, si në vijim: Rritja e pjesëmarrjes së grave në jetën publike; investimet në shërbime lokale që mbështesin pjesëmarrjen e grave në jetën publike; si dhe shkëmbimi i praktikave më të mira. Në pikën e parë, rritja e pjesëmarrjes së grave në jetën publike, jemi munduar t'i paraqesim si në vijim: Nevojat për të investuar në avancimin e barazisë gjinore në strukturat komunale, në veçanti në KKSBB; nevojat për të mbështetur aktivizimin e grave në jetën publike përmes mjeteve të ndryshme, si mentorimi, motivimi dhe veçanërisht investimet tek të rinjtë dhe të rejtat në mbështetjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave; nevojat për të siguruar fonde për politikën e barazisë gjinore në nivelin lokal, përmes buxhetimit gjinor. Në pikën e dytë, investimet në shërbime lokale që mbështesin pjesëmarrjen e grave në jetën publike, jemi munduar t'i renditim si në vijim: Mbështetja e shërbimeve të kujdesit për fëmijët dhe të moshuarit në nivel lokal; mbështetja e transportit për zonat rurale; shërbime gjithëpërfshirëse të ndërlidhura me dhunën ndaj grave me aftësi të kufizuar në nivel lokal. Dhe, pika e tretë, rrjetëzimi dhe shkëmbimi i praktikave më të mira: Investimi dhe aktivizimi i rrjetit formal të grave në nivel lokal, si grupi i grave asambleiste, rrjetit të sigurisë së grave, format e sigurisë në komunitet; tjetra, investimi në bashkëpunim ndërkomunal, duke shkëmbyer praktika më të mira për iniciativat e suksesshme të barazisë gjinore dhe politikën e mira që ofrojnë zgjidhje. Sipas këtyre prioriteteve, ne kërkojmë bashkëpunim nga kryetari i Komunës dhe nga të gjithë ata që shprehin gatishmëri për një jetë më të mirë për të gjithë. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, znj.Suada! Dëshiron dikush tjetër që ta marrë fjalën rreth pikës eventuale? Urdhëro, Artan!

**Artan Loshaj:** Kërkoj falje edhe një herë, por pasi jemi në pikën eventuale, unë nuk due me u lëshue me z.Qamil, me drejtorin, por e kam patjetër me i thonë që edhe një herë mos me u marrë me mu, se unë nuk kam biznes privat. Nëse aludon në biznesin e gruas, po, deshta me i kallxue që në Komunë e kemi të regjistruar më 17.11.2015. Është biznes individual, është biznes i saj. E dyta, ajo nuk ka pronë komunale, ka pronë private që e paguan qiranë mujore. Të lutem, se je i paedukatë edhe i pamoralshëm, herën tjetër mos u merr me këtë çështje. Edhe kërkoj nga kryetari që, në qoftë se nuk të dënon bare këtu në foltore nja dy fjalë, unë po dyshoj se në bashkëpunim me kryetarin jeni duke më sulmue mu. Faleminderit! Shkojmë në pikën tjetër. Pasi jemi në eventuale, unë edhe dje kam diskutuar, e sot për hir të qytetarëve po due me pyet disa pyetje kryetarin e Komunës bashkë me drejtorët. Investimet për vitin 2023, e kemi kubëzimin në fshatin Rrenc. Këtë vit janë investue në dy rrugë, ka pas vonesa pesë

javë, falë kushteve atmosferike i keni krye këto punime. Këtu delegatët e dinë shumë mirë që kanë qenë investim i vitit 2021 për 2022-tën. Duke aluduar se ka pas shtrenjtime të çmimeve, prej tri rrugëve që kanë qenë me u bo, e keni bo veç një dhe e keni vazhduar projekt dyvjeçar. Unë me këtë Asamble këtu, në vitin 2022 për në këtë vit kemi votuar që të ketë kubëzim dhe ndërtimi i mureve mbrojtëse në fshatin Rrenc, në rrugën 'Abdyrrahman Gërdellaj'. Ndërsa, në Rrenc është investuar veç me dy rrugë, vetëm në kubëzim. Due me e pyet kryetarin dhe drejtorin, ku mbeten muret mbrojtëse, s'po e di unë, në qoftë se ka mundësi me e ditë? E dyta, me drejtorin e Shëndetësisë, prej shkurtit 2023 Qeveria e Republikës së Kosovës, në krye me Albin Kurtin, e kanë bo nivelizimin e pagave, po foli për sektorin e shëndetësisë nga vij unë. Tash kryesuesja e re ishalla na ndihmon, se na ka premtuar dje që në janar do ta bëjmë zgjidhjen, që nja dhjetë punëtorë të cilët kanë kryer baçelorin, në vend se të paguhen me koeficientin 5.4, ende vazhdojnë të paguhen me koeficientin 5.1. E dua përgjigjen nga drejtori i Shëndetësisë. Pyetja tjetër për drejtorin e Shëndetësisë, është edhe për kryetarin. E keni qit një konkurs për me i marrë pesë infermierë. Jam shumë i kënaqur që se këta pesë kolegë, pa marrë parasysh kush do të jetë, do të bashkëpunojmë bashkë me këta. Por, një gabim, për mu si asambleist, është që po i merrni vetëm pesë infermierë. Ndërsa te na ka mungesë të teknikut të radiologut, edhe ka mungesë të laboratorit, ka edhe mungesë të mjekut biokimist por s'ka. Është mirë, në qoftë se s'i keni marrë në intervistë, i kam thënë dje kryetarit, prapë merrni të LDK-së, prapë merrni pesë të juajit, por rishqyrtonë këtë konkurs, merrne një teknik rëntgenolog, merrne një teknik laborant, se me të vërtet ka nevojë, ka shumë mungesa. Një pyetje tjetër për drejtorin, edhe pse është punëtor i arsimit, po është këshilltar i kryetarit, unë sa kam marrë informata, nxënësit e fshatit Buqë barten me autoambulancën e dializës. Ju e dini shumë mirë që dy kategoritë, si të sëmurët që shkojnë në dializë, si fëmijët, janë shumë të ndjeshëm. Doktorit e di shumë mirë, aty ka edhe hepatitë, ka edhe viroza. Është mirë në qoftë se ka mundësi, ata fëmijët mos t'i barni me kerr të dializës, së është e pamoralshme. Kurrë kjo në Komunën e Dragashit nuk ka ndodhë. Edhe në fund, z.kryetar, te dëgjimi publik që ishte sot një javë. Kur u futa atë ditë si asambleist që e kam edhe pak obligative me ardhë në dëgjim publik - edhe e kam një kritikë, ndoshta kështu shoqërore, se shumë pak atë ditë kemi qenë asambleistë – kur u futa një herë në fillim, mendova se kam ardhë në ndonjë mbledhim të LDK-së. Asnjë kryetar fshati që janë zgjedhë nga ky Kuvend nuk ka qenë prezent. Vetëm dy kanë folë këtu edhe z.kryetar – janë incizimet – nuk i ka dhënë replikë. Nja dy – tre veta tjerë kanë kërkue, nuk iu ka dhënë, bollni tha se qeqaq mundim. Mu po më vjen keq që disa punëtorë, me ardhjen e LDK-së, i keni dhunue edhe i keni prurë këtu me i bo nja katër-pesë veta, me i bo me i rreh shuplakat. Kjo nuk ka ndodhë, herën tjetër kqyrni, këshillat e fshatit mblidhni, jepnja të drejtën e qytetarëve me folë, mos ua merrni të drejtën, se keni fillue me instalue një kohë, koha e vjetër ajo, mos ta përmendi kohën e komunizmit. Ditën e mirë!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Artan! Për fjalë është paraqit Uran Halimi.

**Uran Halimi:** Faleminderit, kryesues në detyrë! Urime për kryesuesen e re të Kuvendit Komunal! Deshta me u ndërlidhë te çështja e kryesuesit. Po kthehem nja dy vite mbrapa, megjithëse u zgjodh sot zonja Skeraj, të cilën e urova. U çudita me Grupin Parlamentar të PDK-së! Atëherë kur është zgjedhë kryesuesi, në këtë rast unë, këta e kanë lëshue seancën, me atë pretendimin se kryesuesi është pjesë e ekzekutivit, siç edhe jemi konë. Po znj.Skeraj sot, a nuk i përket të njëjtit grup? Tendenca për m'u konë bashkë, e juaja me ta, është parë prej znj.Misinaj, pastaj edhe znj.Bajrami, qetash shkuet edhe krejt. Urime edhe juve për kryesuesen! Ishalla na udhëheqën në mënyrën më të mirë të mundshme!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Uran! Fjalën e ka z.Nexhat Selaj.

**Nexhat Selaj:** Faleminderit kryesues, faleminderit të gjithë edhe një herë! Pasi veç është urue për Arijetën, po të uroj edhe unë. Urime! Veç një përgjigje pak të shkurtë, e tani do të hy pse kam dalë këtu. Uran, një herë të kam thënë, mos të bëhem i tepërt. Ashtu si e keni lyp, ashtu e keni gjet. Keni fillue me LDK-në, jeni ndarë, krejt okej. Por, ne nuk mund të na sugjerosh kënd do ta votojmë dhe kënd jo. Ajo është çështje vetëm e jona, e deputetëve, të cilën ne mund ta shohim të arsyeshme ta votojmë apo jo. Por, ato dështimet e juaja të koalicionit, dëshira është që të mos na bartesh neve, dëshira është që të shohësh me stafin e juaj edhe me ata të cilët në këtë rast ju kanë dalë të pabesë, edhe të vazhdoni dhe të merreni me ta. Unë do të isha ndalë tek realizimet edhe tek punimet të cilat janë punue deri më tani. Në fshatin Zym, me ato mjete të cilat janë derdhë për harxhime gjatë këtij viti, vetëm në kubëzimin e rrugëve që nuk është krye, kryetar, kanë teprue diku rreth 8 mijë euro dhe te ura në fshatin Qollopek janë 7 mijë euro. Në bisedimet të cilat kemi kontaktue ne me ju, në përfundimin e pjesës së parë, keni deklaruar se në pjesën e dytë do të barten këto mjete dhe do të harxhohen. Deri më tani veç përfundoi viti, ne nuk kemi asnjë cent të investuar në atë pjesë. Çka është edhe krejt më e keqja, po më duket se të gjitha projektet – shumë mirë të mbaj në mend nëpër tubimet – gjithmonë ke qenë kritikues dhe ke kritikue se ne tenderët nuk do t'i hapim në shtator, e të mbesin ato për vitin tjetër, por do t'i hapim në prill dhe do t'i vazhdojmë gjatë kohërave të nxehta. Unë nuk e di sa projekte keni realizuar dhe ku i keni ato projektet kur, jo ju në shtator, por edhe në nëntor e në dhjetor jeni duke punuar. Ndoshta e keni gjet momentin e investimeve, nuk po mundem me thënë se jo, por kohën nuk e keni, kryetar. Ne e dimë se jemi prej viseve të larta malore, temperaturat pothuajse i ke minus. Në ato vende ku është duke u investuar edhe ku janë duke u kryer punimet, temperaturat i ke të vlerave minus. Çfarë qëndrueshmërie do të kenë ato investime? Nuk e di, ke qenë, gjithashtu keni përruar vetëm fillimet e punimeve, nuk e di a keni dalë në mbarimet e punimeve. Në Qollopek, te ura aty ka qenë 50 metër e planifikuar që të zgjerohet, që të vazhdohet rruga jashtë urës. Aty jo që nuk është punuar asgjë, por është bërë e pakalueshme. Urë kemi ndërtue, kalim nuk kemi. Ne për këto duhet të merremi edhe për këto ma tepër duhet të debatojmë, edhe t'i pranojmë edhe ato kritikën të cilat janë pa vend, por

t'pranojmë edhe kritikën të cilat janë me vend. Në fillim të mandatit keni shprehur mendimet të cilat mezi se i kemi prit të gjithë, se nuk është vetëm në interes të fshatit Zaplluxhe, por është rrugë e cila lidh edhe në pjesën e Zhupës poshtë. Në hyrje të fshatit Zaplluxhe keni thënë, keni deklaruar publikisht se do të ndërtohet ura. Në fillim keni deklaruar se do të është investim në kuadër të Komunës, tani vërejtet diçka parregullsi, thotë se është në kuadër të Ministrisë. Përpos që ngjason në kërcimore skijash ajo urë, nuk ka tipare të urës ajo. Ku ka mbet, çka është në pyetje, është mirë që të dalim këtu edhe të dokumentojmë, ju apo stafi juaj. Rruga Brrut-Zgatar, kur u mor tenderi, tha mezi e kemi pritur, firmë shumë e fortë, që ka bërë punë të mira për trevën tonë. Pasi është hap ajo, dolët një mori fotografish që po fillojnë punimet. Te ndërtimi, kemi vërejtur aty që janë dhejtëra metra të cilat asfalti është humbur. Kush jep llogari për atë dhe kush merr përgjegjësi për këtë? Ndoshta më vonë do kemi edhe pak. Më fal! Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Nexhat! Para se me ia dhënë fjalën dikujt tjetër, më falni z.Nexhat, përkundër konsideratës që kam ndaj teje, pak më parë shprehe dyshimin se unë a do t'i rezistoj kësaj udhëheqjes së mbledhjes. Unë kam bindjen që do t'i rezistoj. I kam rezistuar edhe shumë tubimeve ma të ashpra ndoshta, por vlerësimi yt të cilin e dha për delegatët e LDK-së – besoj që aludohet në delegatët e LDK-së – që janë të pabesë, kjo nuk ju shërben për nder. Ngase, unë nuk kam bindjen se delegatët e LDK-së janë të pabesë. Këtu duhet të iu kërkoni falje delegatëve të LDK-së, ngase ky konstatim nuk qëndron. Unë po të tregoj ty që unë dhe kryetari jemi ndër themeluesit e LDK-së, dhe asnjëherë si delegat nuk e kemi tradhtuar askënd. Kam bindjen që këta të rinjtë janë edhe më të përkushtuar se ne. Prandaj, ky fjalor nuk duhet të përdoret në seancat e ardhshme. Po, meqenëse të apostrofova, urdhëro!

**Nexhat Selaj:** Faleminderit edhe një herë! Nuk i përkas shumë replikave, ta Mehmet, por s'di sa më kuptove. Nuk thashë të pabesë për delegatët, por iu drejtova z.Uranit që na akuzoi neve për gjoja se votimin. Dhe unë isha shumë i prerë në fjalor edhe shumë i qartë. Nuk ju quajta tradhtarë, por thashë të pabesë në koalicionin të cilin e keni formuar. Fjala 'e pabesë', a mundet disi ma ndryshe, ma e butë të zberthehet, nuk e kuptoj unë se është fjalë ofenduese. Keni lidhë – thashë Uranit – koalicion, ju kanë dalë nga besa, të pabesë. Do të thotë, unë nuk e shoh këtë ofendim, që kam ofendue delegatët ose kam ofendue dikë tjetër. Fjala 'e pabesë' është njëra prej atyre fjalëve më të buta të fjalorit, e cila mund të përdoret. 'Tradhti' nuk përdori, se nuk e kam shprehur të përdori fjalën 'e keni tradhtu', por është e pabesë, e dalur nga besa. Unë nuk po kuptoj se ofendova diçka. Nëse e ke marrë gabim, më vjen keq, unë e përdora vetëm fjalën 'e pabesë'. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Nexhat! Fjalën e ka z.Uran për replikë.

**Uran Halimi:** Tash po vijmë çështje mas çështjeve, fjalë mas fjalëve. Sa herë po bëni replika, po m'i kujtoni edhe do fjalë tjera. Po më pëlqen shumë kjo. Sa i përket asaj 'pa besë' që tha profesori, paraprakisht kjo është e dëshmuar, e përkrahi edhe e mbështes atë fjalën që ti e thaje. Nëse ju vret – i

nderum kryesues në detyrë, mos e merr personalisht, por si subjekt politik, se unë personalisht me kërkond ...personalisht munda me e pas me kryetarin, se ai e ka nënshkruar marrëveshjen, por që jeni të pabesë si subjekt politik, këtë e di edhe qytetari i Dragashit, po edhe në Kosovë njiheni si parti e të pabesëve. Arsyetja që dola me e dhënë replikën këtu, me nxiti z.Nexhat Selaj që e bëri një replikë mas meje. Unë edhe qytetarëve të Dragashit, edhe juve në Kuvend, ju kam thënë që, me më shkarkue veç LDK-ja hiç s'kam qef, s'më plëqen hiç. Shumë kam qef me më shkarkue edhe ndonjë votë e PDK-së. Nja dy vota të juajat janë konë, te njona...se thatë një është rezervë, jo s'e ka lënë vetëm Xhemilen e kushedi çka, jua solla punën edhe një herë me e pa që, s'u konë bash puna mos me e lënë vetëm Xhemilen. I obligoheni me disa raste, jau konda pushteti me shumë raste. Po është mirë që qytetari me vendos në zgjedhjet e ardhshme. Kush çka kemi veprue dihet. Po të më kishit mbështet në kohën kur jam zgjedhë kryesues, tybe që jau kisha thonë këto fjalë. Ama, ju nuk më mbështetet, më shkarkuet, e mbështetet një kryesues të LDK-së. Çka po i bjer kjo, i nderumi koleg? Bashkëpunim i mirëfilltë politik. Mirë u pafshim!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Uran! Fjalën e ka Nedžmidin Sejdlar.

**Nedžmidin Sejdlar:** Zoti Spahiu, mendoj se duhet të largoheni nga ai vend, sepse ministria do të na e kthejë këtë seancë si të paligjshme. Pastaj do të duhet të votojmë sërish për kryetar të Kuvendit. E kam të qartë që ju nga qeveria nuk mund të kaloni asnjë seancë pa na kthyer Ministria. Ju kërkoi që për hir të qytetarëve që presin shumë nga ne, ta lini kryesuesen në krye të seancës sepse ne e kemi zgjedhur tashmë. Një gjë tjetër, më intereson organizata joqeveritare Human Care, së cilës i kemi dhënë rreth 186 mijë euro vitin e kaluar, nëse ka sjellë ndonjë raport dhe ku i ka shpenzuar gjithë ato para. Unë nuk heq dorë nga kjo çështje, edhe pse e kemi diskutuar më parë këtë çështje. Unë jam shumë i interesuar dhe për hir të gjithë atyre qytetarëve të komunës, pse i japim kaq shumë para asaj dhe organizatës joqeveritare, për çfarë i kanë shpenzuar ato para. Kam informacione se e kanë subvencionuar edhe në vitin 2023. Së treti, as që mund të ëndërroja që administrata komunale do të përdorte faqen zyrtare të komunës për të komentuar statuset e mia në Facebook. Kështu ndodhi këtu me organizatën fantazmë joqeveritare Sensa. Administrata komunale ka komentuar se nuk i kuptoj faturat që më kanë dhënë vetë. Ndër të tjera ju shpjegova se keni thyer shumë ligje në këtë çështje. Per ditën e Goranëve le te vije një i gjalle te me shpjegoje kush blen laptop. Si ka mundësi që dikush të blejë një laptop. Për katër vite punë këtu në këtë kuvend, ne morëm hua një laptop 5090 euro dhe ajo për dy orë e gjysmë të projektit, komuna e miratoi Sensin që të blejë një laptop prej 800 eurosh. Le të më shpjegojë dikush i zgjuar këtu se çfarë lidhje ka laptopi me festën e Goranëve. Edhe qytetarët që na dëgjojnë nuk mund ta kuptojnë pse keni shpenzuar para për laptop. Le të na shpjegojë ajo Senska se si ka shpenzuar 170 euro në udhëtimin Dragash-Prizren kur ka marrë vetëm një faturë nga Prizreni. Në raportin që keni dhënë është vetëm një faturë nga komuna e Prizrenit dhe shpenzimet e udhëtimit janë 170 euro. Kur e ndajmë në

kilometra, del se e kemi festuar ditën e goranëve në Budapest. Gjithsesi ishte një sallë bosh. Si e pranuat atë raport? Ju duhet të filloni procedurat zyrtare ligjore për shpërdorim të parave. Projekti që ai kërkoi zgjati dy orë e gjysmë, ju miratoni dy paga mujore për koordinatorin. Cili komision e miratoi dhe ku i kishin sytë? Ju keni një projekt njëditor dhe miratoni dy rroga për koordinatorin. Pse po i shpërdoroni paratë e këtyre qytetarëve. Nëse projekti mund të realizohet për 1000 euro, le të kryhet për 1000 euro. E patë se çfarë faturash keni në atë raport, sikur të ishin të shkruara në një pecetë. Ke nje bllok paragon me numer serial qe ka perdor vete Sensa, i leshuar 600 euro per muzike, pa firme, vule, date. Dhe ju i pranuat të gjitha. Pastaj ju e keqpërdorni faqen e komunës dhe më akuzoni mua për lajthimin e opinionit. Pse po shpenzoni paratë publike. Dhe pastaj ju sulmoni dikë pse proteston. Pres që të gjithë çështjen ta çoj në prokurori. Duke pasur parasysht se praktikisht po ju demonstroj për parregullsitë nga keqpërdorimi i parasë publike. Banorët e fshatit Radesh presin që ju, kryetar, të shkoni tek ata me stafin tuaj dhe t'u shpjegoni për lumin. Me të drejtë janë të mërzhitur. Ata ju dërguan një peticion, ju ftuan të bisedoni dhe tani presin që ju të shkoni atje lart me ekipin tuaj dhe të flisni për atë lumë dhe çfarë do të ndodhë më pas me atë lumë.

**Mehmet Spahiu:** Dëshiron dikush tjetër të marrë fjalën? Fjalën e ka Jetmir Ajdini.

**Jetmir Ajdini:** Edhe një herë përshëndetje për të gjithë! Së pari urojmë znj. Skeraj për pozitën e re, dhe pasi që veç e kemi kryesuesen e re të Kuvendit Komunal, të kisha ftue që ta udhëhiqni mbledhjen e Kuvendit Komunal, ose po bëhemi Kuvend Komunal me dy kryesues.

**Mehmet Spahiu:** Jetmir, unë deshta me i dhënë përgjigje edhe Nexhës, por po të jap edhe ty nëse ka nevojë.

**Jetmir Ajdini:** Okej. Po, ka nevojë, se përderisa është kryesuesja...

**Mehmet Spahiu:** Ne kryesuesen e zgjedhëm të Kuvendit Komunal, edhe kjo m'u lut, për shkak që ka pengesa me zërin, ta vazhdoj unë seancën. T'i heqim dilemat.

**Jetmir Ajdini:** Ah, okej, atëherë në rregull, se po bëhemi Kuvend Komunal me dy kryesues.

**Mehmet Spahiu:** Nuk ka problem, se unë me vetëdëshirë s'e kisha pranue kurrë këtë detyrë.

**Jetmir Ajdini:** Në rregull. Do të vazhdoj dhe do t'i bëj disa pyetje për ekzekutivin komunal, në lidhje me buxhetin që është ndarë për fshatin Zgatar. Për vitin 2023 është shuma prej 8 mijë eurosh që e kemi ndarë për investime në pompat e ujit të fshatit Zgatar, investim i cili ende nuk është bërë. Është fundi i vitit, as nuk kemi parë projekt, as nuk kemi investim diçka, as nuk kemi punime diçka në atë aspekt. Është veç fundi i vitit, është muaji dhjetor dhe, po besoj që ato mjete do të na shkojnë në suficit, edhe fshati Zgatar do të vazhdojë me problemet të cilat i ka pas me ujësjellësin, konkretisht me pompat e ujit. Pyetja tjetër është në lidhje me kubëzimet që janë bërë në rrugët edhe rrugicat e fshatit Zgatar. Është investue një shumë e mjeteve, kanë teprue një shumë e mjeteve diku 6 mijë e diçka euro, që janë tepricë. Keni thënë që në fazën e dytë do t'i ritenderojmë, nuk i kemi pa. S'e dimë a janë investue ato,

a ka fitue dikush tender, a do të investohen ato mjete shtesë që janë. E dimë që rruga në familjen Murati është për gjysë, edhe disa rrugë të tjera të cilat kanë mbet pa përfunduar. Pyetja tjetër është në lidhje me shumën e mjeteve e cila është ndarë për rrugën Brrut-Zgata, rrugë e cila është kryer momentalisht. E kemi pa cilësinë e punimeve, dy javë pasi është krye ajo rrugë, asfalti veç është i plasaritur në disa pjesë. Ajo shumë ka qenë diku 7 mijë euro, që ka përfshirë edhe rregullimin e gropave në fshatin Brrut, në fshatin Kosavë edhe disa fshatra tjera, investime të cilat nuk i kemi pa, ato gropa vazhdojnë me qenë prezente hala. Nuk e di ku shkojnë ato mjete edhe a do të kthehen në suficit të gjitha ato mjete të buxhetit komunal, edhe qytetarët do të mbesin prapë me të njëjtat problematika. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Jetmir! Dëshiron dikush tjetër të marrë fjalën? Urdhëro, z.Driton!

**Driton Ademi:** Faleminderit! Unë i kam disa pyetje këtu. Një pyetje – edhe pse shkoi kolega Naser – shumë kam kërkesa prej shkollës, prej mësuesve të shkollës që nuk janë duke e ditë kush është drejtor në shkollën e fshatit Bresanë. Me sa kam informacione – nuk e di sa është e vërtetë, veç me sa më kanë thënë – në zyrë të drejtorit hyn e del shumica. A mos ndoshta u ndërrue U.D., për shkak të mediave ose nuk e di për çka. Domethënë, nëse ka ndonjë vendim tjetër, është mirë me dalë publikisht me ua thënë mësuesve, se nuk janë në dijeni kush është U.D., se drejtor hala s’ka, se e keni qit konkursin e ri. Pyetja e dytë, kryetar bashkë me drejtorin e Financave, ju i keni ndarë rreth 60 mijë euro për QKMF-në. Domethënë, QKMF me AMF - çka quhet kjo në Bresanë, ambulante po e quaj – ju i keni ndarë 3,500 euro më duket, mos gabofsha. Një ambulante që i ka me qindra, mijëra pacientë në vjet, ndahen 3 mijë euro, shkon e ndahet AMF-it në Kosovë i ndahet, nuk e di sa, mbi 10 mijë euro i janë ndarë. Kjo është diçka shumë e patolerueshme. 17 mijë, domethënë edhe hala ma shumë që i kie, ndoshta a i marrin 5 injeksione në ditë a s’i marrin. Plus në Blaç, domethënë, që është ma katastrof, investohet në AMF, nuk investohet në Bresanë në QMF, as në Dragash. U ndahet disa fshatrave aty që s’kanë pikë të interesit ose s’kanë shërbime që munden me marrë ata. Unë e kam edhe një pyetje tek bursat të cilat i keni ndarë. Nuk e di në mënyrë ligjore sa është e drejtë, por unë po mendoj që bursat, një qytetar është njësoj taksapagues edhe që e ka fëmijën si në shkollë private, si në shkollë publike. A nuk e meriton edhe ai që e ka në shkollë private me marrë bursë? Apo ju i keni dhënë prioritet veç shkollave publike? Këtu ka shumë taksapagues të Komunës që vetëm ju keni dhënë bursë vetëm studentëve të shkollave publike, jo private. Uran, s’po due me ta përmend emrin, po e di që po duesh me replikue po s’po due. Faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Fjalën e ka z.Shpetim Hajredini.

**Shpetim Hajredini:** Atëherë, përshëndetje edhe një herë për të gjithë! Unë personalisht nuk po di, more burrë, tash kjo çështja e politikës ish...katër vite kam qenë, por kena pas ekzekutivin edhe shumë s’iu kam vu rëndësi bisedave apo, çka po di, këtyre konflikteve verbale të fjalëve. Por, edhe qeqaq që ndikon politika apo pozita në personalitetin e një njeriu, s’e kam besue. I nderuar ish-kryesues, unë

personalisht nuk njihem shumë për filozofi, e din ti mirë këtë. Unë mundohem atë që e di edhe që duhet me e thënë, që ka ndikim te qytetarët, atë e them direkt, edhe nuk mundohem me fitue politikisht, absolutisht asnjëherë nuk e kam përdorë këtë foltore që të fitojë politikisht. Ajo që ti e morre fjalën dhe dole këtu, thaje që ne të PDK-së kur ke qenë ti kandidat, na kena dalë jashtë. Ajo kohë është krejt tjetër, ndërsa sot pas dy viteve është krejt tjetër, dhe kandidat tjetër. Dhe, natyrisht që ne u japim përgjegjësi dhe llogari vetëm atyre qytetarëve të cilët na kanë mbështet neve deri më sot. Nuk jem këtu për me i dhënë llogari as ty, as kërkujt tjetër, përveç se atyre. Edhe ne e marrim vendimin ashtu qysh mendojmë që është në të mirë të qytetarëve. Në atë kohë kena mendue që nuk është në të mirë të qytetarëve dhe kena dalë jashtë, nuk kena votue, ti i ke marrë votat, i ke pas votat, ke qenë kryesues. Por, mos harro se na jemi mundue në maksimum me të mbajt ty. Aq kena pas mundësi, por e kena dhënë atë mundin e fundit, atë fuqinë e fundit me të mbajt. Por kjo ishte, ata të cilët të vendosën, ty të votuan, ty të shkarkuan. Ti duhet të merresh me ta, e jo me ne. Por s'ka rëndësi, pak ka rëndësi, edhe nëse don me u marrë me ne, ne prapë jemi ata të cilët kemi qeverisur shumë vite me këtë Komunë, jemi të bindur që prapë do të kthehemi edhe më të fuqishëm në zgjedhjet e ardhshme. Nëse doni me qeveris me njerëz të sinqertë, njerëz të cilët dinë si qeveriset dhe e mbajnë fjalën, vjen me ne edhe nuk i prish muhabetet me ne. Po nëse don me vazhdue qysh ke vazhdue deri më tash, s'është problem për mu, a po kuptojsh. As për PDK-në, se ishalla nuk jemi të varur prej votave të një partisë tjetër. Tjetra, i nderuar kryetar, nuk do të thellohem, kam shumë diskutime dhe shumë pyetje rreth projekteve, por unë kam dëshirë të diskutoj vetëm kur është momenti i duhur dhe kur është pikë e rendit të ditës të diskutohet për atë, atëherë diskutoj. E pres raportin edhe atëherë të bëj pyetje. Por një pyetje, e mbaj në mend, s'e di në cilën seancë se kemi bo shumë seanca, radhazi në shpejtësi, edhe s'po muj me majt në mend, i ka pesa a gjashtë seanca që ta kam bo një pyetje dhe një kërkesë ta pata parashtrure, që në rrugën Kuk-Kosavë, ajo përrocka andej anash që ne i themi vijë apo si të duesh t'i thuash, që është përfundue tanimë kubëzimi i asaj rruge, pata kërkuë që të hapet edhe një herë, për shkak se është bllokuar dhe uji po kalon në prona, po i dëmton pronat publike, po edhe janë private ato tjerat. Prandaj, unë kam qenë tash, se nuk kam dalë një kohë të gjatë nga ajo rrugë, dola tash dhe shikova. Jo, absolutisht, të thashë shqip, thashë vijë apo kullimi i ujit që bëhet, vijë ne i themi në katund, edhe ti besoj që e din çka është vija, apo kanal ujqor që e përdorim. Unë të pata kërkuë që të hapet ajo. Ma dhaje fjalën, thaje po do të kryhet ajo punë, se thashë edhe nëse nuk është në projekt që të hapet prapë, të diskutoni me kompaninë, nuk i ka kushtue asgjë 200 metra ta hapë edhe një herë atë kanal. Mirëpo, e pashë që ai kanal nuk është prek dhe nuk e kanë mbajt fjalën, por nuk kam hy në detaje me e kqyrë projektin sa pare i janë lëshue asaj kompanisë dhe çka ka ndodhë. Por, kam besue në ty që e mban premtimin edhe ma kryen këtë problem, por kjo e pashë që nuk ish krye. Dhe në fund, se në fillim nuk ta urova. E nderuar Arijeta Skeraj, kolege, urime pozitive e re, të uroj suksese, je e duhura. Gjithashtu, unë shfrytëzoj rastin në këtë foltore që t'u

dëshiroj mirëseardhje të gjithë atyre bashkatdhetarëve të cilët tani gjenden në qytetin tonë, në fshatrat tona të cilat na i kanë zbukurue. U dëshiroj që të kalojnë çaste dhe pushime sa më të mira dhe të këndshme! Ju faleminderit!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Shpetim! Uran Halimi e ka fjalën.

**Uran Halimi:** Po dal shpesh, kam me dalë shumë ma shpesh, jam çlirue qetash. Po e nisi te një stadion i Blaçit, shumë zhurmë kemi bo atëherë. Kryetar, shënoje qaty, jem konë e kam pa gjatë punimeve drenazhën që e kanë bo për kullimin e atij stadionit. Gypat që i kanë shti janë fi 100, nuk e di sa janë në projekt, mundohnu me hulumtue projektin. Në ata gypa, kur janë fut në stadion, asnjëri prej tyre nuk e ka atë zhavorrin i cili përdoret për drenazhim. Është fjala për 'llauf' që i themi ne. Kryetar, unë të ftoj me shkue me i çelë ti ata gypat për kullimin e stadiumit, nëse ndonjëri prej tyre ka llauf në të, atëherë unë dal të kërkoj falje publikisht. Edhe kullimi i qatij stadionit e ka shkatërrue komplet atë investimin në parkun e fshatit Blaç. Ka reague edhe faqja e Blaçit, nëse jeni konë në gjendje me e pa, qato vërshime, qato ujëra të të reshurave, vazhdimisht e vërshojnë rrugën e Mahallës së Epërme, që i themi ne asaj mahallës te shkolla. Edhe qytetarët atje në fund të rrugës kanë probleme, se ai uji i të reshurave u futet edhe nëpër oborre, e besa me bo mos me evitue me mjete vetanake qytetarët, iu futet edhe në shtëpi. Është mirë me u marrë me këto çështje. Sa i përket kërkesës së banorëve të fshatit Blaç, kemi folë edhe më herët në lidhje me ato kaptazhat e ujësjellësit. Mundohnu mos me na zënë vera, se vijnë gurbetçinjët e mbesim pa ujë apet në verë, bare le të kenë ujë kur të vijnë këta gurbetçarët që i presim me shumë dëshirë. S'e di a e ke hulumtue kur të kam thënë që kaptazhat e fshatit Blaç janë krye me letra. Nuk e di a ke hulumtue, më ke thënë kie me mbajt përgjegjësi. Unë mbaj përgjegjësi prapë. Qetash s'jam kryesues, mundish me m'lyp llogari, të jap llogari edhe për ato. E kanë pa edhe qytetarët që me letra i keni krye kaptazhat, po s'i keni krye. Kemi edhe fotografi edhe dëshmi për atë çështje, nëse të vijnë veç më kontakto, kryetar. Po ndërldhem edhe te Shpetim Hajredini. Tha që nëse duesh me qeveris me besnikë, hajde. Unë qeverisi me LVV-në ti, Shpetim. As me LDK, as me PDK. Emrin ta përmendi, se kam qef me bo replika, na jemi për me bo debat. Unë qeverisi me LVV-në, përfaqësoj LVV-në, dinjitetshëm. Më keni akuzue vazhdimisht, Urani u shit në LDK, me një kohë, s'e di a e dini. Po qetash vonë u pa që kush u shit edhe ku u shit. Unë s'jam shit kërkund, unë këtu jam. Kështu që, e përfaqësoj LVV-në, kështu me fytyrë edhe me gjithçka. Faleminderit shumë!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Uran! Fjalën e ka Agron Gashi.

**Agron Gashi:** Atëherë, edhe një herë ju përsëndes, të pranishëm! Dola vetëm shkurt, po mundohem të jem sa më i shkurt. Unë isha këto ditë në Prizren dhe dalja nga Prizreni deri në fshatin Brezne më shkaktoi aq vështirësi sa që, të them të drejtën, edhe jeta ime ishtë në rrezik edhe e familjarëve që i kisha brenda, por edhe ata anashkaluesit tjerë. Dhe, megjulla që kaplon nga Zhuri deri në pjesën nalt këtu, është një megjull shumë e dendur dhe rruga regjionale nga Zhuri deri në trevën tonë këtu në

Dragash, është puna që nuk figuron vija e bardhë dhe shkakton vështirësi të mëdha, sa që jeta e qytetarëve është në rrezik. Atëherë kryetar, ju kisha lutur juve si ekzekutiv komunal, të ngritni këtë çështje deri në organet më të larta dhe – nuk është e kushtueshme shumë – por të mbrohen qytetarët, të merren masa në këtë drejtim, se vërtet jeta vërtet jeta është në pyetje. Faleminderit shumë!

**Mehmet Spahiu:** Faleminderit, z.Agron! Nëse nuk ka dikush tjetër, kryetar dëshiron të marrësh fjalën? Po ju informoj se pas përfundimit të përgjigjeve të kryetarit, seancën do ta mbyllë kryesuesja e sapozgjedhur, zonja Arijeta.

**Bexhet Xheladini:** Ju e dini që debati publik, me ligj kryetari është i obliguar dy herë në vit me e bo me qytetarët. Ne procedurat ligjore i kemi ndjek, e kemi qit në uebfaqe, në mjete të informimit, i kemi ftue qytetarët. Unë atë ditë kam qenë i lumtur që kjo sallë ka qenë plot. Kam qenë edhe më shumë i lumtur që gjysma kanë qenë femra. Debati ka qenë jashtëzakonisht i suksesshëm. Sa i përket pranimit të infermiereve, ju shumë herë jeni ankue në këtë foltore për mungesë të infermierëve që nga dy infermierë të kujdestarojnë. Ne kemi shpallë konkursin, është në procedurë të pranimit të pesë infermierëve. E di që ka nevojë edhe për ato që thaje, por ne i kemi planet tona, se tash na jemi në qeveri edhe ne dimë vetë kur duhet me i bo ato punë. Normal, sugjerimet i pranojmë, por ne punojmë qysh duam ne edhe kur duam ne. Sa i përket punimeve në fshatin Zym, është e vërtete që kanë mbet 8 mijë euro. Mjetet na i ka marrë përmbaruesi për pagesën e kontratës kolektive. Përmbaruesi, kur të vjen vendimi i prerë, nuk pyet ku t'i merr paret. Te ura, u shpallë tenderi për fazën e dytë, për fat të keq, është nënshkrue kontrata, po ra bora edhe ato mjete kanë shkue në suficit. Mirëpo, me buxhetin e vitit të ardhshëm, ne atë urë do ta rregullojmë edhe mjetet që kanë shkue në suficit për fshatin, do t'ia kompenzojmë. Ura te Zaplluxhja, ju e dini që iniciativa ka qenë e imja, kam bo marrëveshje me personin i cili e ka lëshue atë, mirëpo ai është investim i Ministrisë së Infrastrukturës. Për fat të keq, aty ka dalë një problem te kualiteti i betonit. Unë muj me ta dokumentue që, së paku nja 20 herë me Ministrinë kam bisedue, mirëpo për shkak të rrugës së Brodit – se ka qenë e njëjta kompani me e krye – atë natë kur u krye rruga e Brodit, atë natë ka ra borë, ju e dini, edhe ka mbet ajo rrugë pa u krye, por ajo do të kryhet vitin e ardhshëm. Rruga Brrut-Zgatar është projekt dyvjeçar. Ju e dini që unë e kam qit një status në Facebook që, për shkak të presionit qytetar, ne jemi detyruar ta shtrojmë atë rrugë me asfalt, edhe pse ajo rrugë ka pas nevojë të fle edhe ma tepër, sepse aty është bërë një mur mbrojtës shumë i gjatë dhe ka qenë një humnerë mes murit dhe rrugës, e cila është dashtë të flejë. Kompania nuk ka guxue me e bo ngjeshjen me vibrator për shkak se muri nuk ka qenë i pjekur edhe tash aty ka pëlçit. Por kjo rrugë përveç që është projekt dyvjeçar, ka edhe garancion. Unë sot kam bisedue me punëkryesin, në pranverë vjen dhe ajo rrugë rregullohet. Ne, për dallim prej qeverisjeve të juaja, ne vitin e kaluar e kemi realizue buxhetin 96%, sivjet e kemi realizue afër 97%. Mirëpo, tri reshjet e borës na i kanë hup nga 10 ditë punë, një muaj ditë punë, kështu që na do ta kishim bërë edhe qind për qind.

Sa i përket pyetjeve të Nedžmidin Sejdilarit, masi ai nuk është këtu, nuk e kam për obligim edhe me i dhënë përgjigje. Të gjitha ato që i ka thënë janë insinuata të tijat, mendime të cilat nuk kanë kurrfarë baze për me iu dhënë përgjigje. Sa i përket Radeshës, është e vërtetë që ka ekzistue një peticion online. Unë u kam kthyer atyre përgjigje. Unë jam duke e vazhduar të njëjtin projekt të cilin e ka bo qeveria e kalume. Nuk kam ndërhy fare në projekt, edhe për ujin e Radeshës ekziston kontratë edhe marrëveshje mes qytetarëve të Radeshës dhe ish-qeverisë komunale. Kështu që, ato çka tha Sejdilar janë disa prapavija të këqija, të cilat ky është një prej atyre që është duke i bërë, bashkë me disa të tjerë. Por, Ujësjellësi nuk do të ndalet, sepse kontrata është nënshkruar, mbi 30% të punimeve janë kryer, janë ndarë mjetet edhe 2 milionë euro për përfundimin e këtij Ujësjellësi. Edhe ky Ujësjellës do të përfundojë, pavarësisht që dikujt nuk po i pëlqen. Doktor Jetmiri, 8 mijë euro për pompat, ka qenë tenderi i hapur edhe nuk ka konkurue asnjë kompani edhe tenderi ka dështue. Mjetet i ka marrë përmbaruesi. 6 mijë euro që kanë teprue për kubëzim – ka qenë tenderi hapur për kubëzimin e rrugës kah shkolla që shkon – nuk është paraqit asnjë kompani. Këto mjete kanë shkue në suficit. S’ka pas kohë më, se ato 6 mijë eurot, na i kemi ndreq në Zgatar hiç më pak se 10 rrugë, i kemi kubëzue, nashta e dish. Edhe kanë qenë të parapara 60 mijë, kompania ka hi me 54 mijë. Kanë mbet 6 mijë euro, këto pa përfundue projekti ekzistues nuk mujsh me i qit në tender këto. Kur ka përfundue projekti ekzistues, mjetet që kanë mbet i kemi qit, nuk është paraqit asnjë kompani. Këtë vit ne kemi pas probleme me kompanitë. Përveç që nuk ka pas kompani të mjaftueshme, kompanitë të cilat i kanë marrë punët në fillim të viti i kanë pas, për shembull, 20 punëtorë, në fund të vitit iu kanë mbet 10 ose 5 punëtorë. Për atë edhe një pjesë e mjeteve na kanë shkue në suficit. Dritoni tha është investue shumë pak në QMF-në e Bresanës dhe është investue më shumë në Kosovë edhe në Blaç. Ka pas nevojë ma shumë në Blaç, për arsye se u investue në kullm, është hek krejt, ka qenë prej azbestit edhe është dashtë të hiqet ai, për atë janë dashtë ma shumë mjete. Edhe në Kosovë po ashtu ka pas nevojë. Në Bresanë ka pas nevojë ma pak edhe u investue ma pak. Është bërë mediatike, se nuk ka qenë shumë, një tualet ka qenë, nuk ka pas aq probleme sa është paraqit. Te bursat, unë si kryetar kur kam ardhë e kam gjet një Rregullore komunale për ndarjen e bursave, të cilën e ka miratue pushteti i kaluar. Ne duhet ta zbatojmë atë rregullore deri sa të ndërrohet ajo. Në atë rregullore shkruan se bursa u jepen vetëm studentëve të cilët studiojnë në universitete publike. Ne konkursin e kemi paraqit në bazë të kriterëve dhe unë mendoj që është një Rregullore e mirë. Por nëse ju mendoni që duhet me e ndryshue, mujm edhe me e ndryshue. Hapjen e kanalit që i paskam dhënë fjalë nuk po më kujtohet, por ajo qenka punë e vogël, ajo mund të kryhet, nuk është problem. Por nuk po më kujtohet, kërkoj falje. Stadioni i Blaçit edhe për kaptazhat, e kisha lut një minutë vetëm, jo ma shumë me zgjat, drejtorin e Administratës, pasi e di këtë punë ma mirë. Sa i përket pyetjes së Agronit për sinjalizimet në rrugën Zhur – Dragash, unë për këto kam bisedue me përfaqësuesin e Ministrisë më së paku 10 herë. Kam kërkue – bile jam duke e thirrë në telefon – por

nuk kam has në mirëkuptim. Mundi me e dëgjue edhe ju, s'po përgjigjet, sigurisht është i zënë. Së paku 10 herë kam kërkue që sinjalizimi i kësaj rruge të bëhet, për shkak se është kërkesë e qytetarëve. Ai më ka thënë që kur është bërë projekti nuk janë paraparë sinjalizimet. Mirëpo ka thënë që do ta bëjmë. Tash është vonue kjo punë, sigurisht që e bëjnë, ma merr mendja që kanë me e krye. Nuk besoj se i mbeta dikujt borxh. Dëgjo, për bartjen e nxënësve të jam përgjigj në Komitet. Të thashë që është për herë të parë që po e bëjmë ne transportin e nxënësve, për Rrenc po flas, për shkollën e mesme. Normal që ka vështirësi, të cilat vitin e ardhshëm edhe ditët në vazhdim do t'i eliminojmë. Është e vërtetë që kanë probleme, kur po bjer borë autobusi s'po mund me shkue atje. Kam pas ankesa jo vetëm prej teje, edhe prej qytetarëve, por jemi zotue që këto probleme t'i zgjidhim. Sa i përket transportit të nxënësve të Buqes, tash shkolla e Buqes është meremetue dhe janë duke punue shkolla e Buqes. Një kohë, kur është bërë renovimi i asaj shkolle, e kemi bërë transportin e nxënësve me kerr të ambulants. Është normal, s'ka pas këtu asgjë të keqe, pse me i lënë nxënësit me shkue në këmbë, kur punëkryesi u vonue, nuk i ka krye punët me kohë edhe nxënësit, mos me e hup mësimin, ne i kemi transportue falas. Për murin mbrojtës që të thashë edhe për kubëzimet në Rrenc. Kur është shpallë tenderi është shpallë për të gjitha, mirëpo nuk kanë mjaftue mjetet edhe është bërë vetëm kubëzimi i atyre rrugëve. Mjete nuk kanë mbet, nuk kanë teprue. Po ti e dish kur janë krye, më 21-22 është krye kubëzimi. Fol, qe po të përgjigjem prej këtu. Unë të tregova vonesat pse kanë ndodhë. Të thashë mungesa e kompanive. Nuk ka ndodhë vetëm tek ne. Kompanitë kanë marrë nga 5-6 punë në fillim të vitit, s'kanë mund me i krye, mungesa e punëtorëve. Kjo nuk është vetëm te ne, por është në mbarë Kosovën. Po unë të thashë, ne jemi të lumtur që në fund kemi arrit që buxhetin ta realizojmë diku afër 97%. E kisha lut Vetimin për këto dy pyetjet që i ka bërë...jo, po i ka edhe fotografitë me ta dëshmue ty që..ani dëgjo, e ke prokurorinë, unë jam me ty. Nëse është qashtu, unë vij e nënshkruaj padinë ndaj asaj. Nuk është problem. Ku, për çka është fjala? Dëgjo, ti ke thënë për kaptazhat. Kaptazhat nuk janë krye edhe nuk janë pague as me letra. Shko këqyre në Zyrë të Prokurimit a janë pague a jo. Tenderin e di, por shko këqyre a janë pague.

**Arijeta Qafleshi Skeraj:** Faleminderit, kryetar! Tash, a po doni me marrë përgjigje prej drejtorit të Administratës a jo? Okej. Fjalën e ka Vetim Ramadani.

**Vetim Ramadani:** Faleminderit, kryesuese e re! Urime për punën! Meqenëse njerëz të VV-së këtu po e lëshojnë sallën, unë kisha dashtë veç një llaf me e citue liderin e tyre suprem: 'Ti edhe mundesh, po masnej s'mundesh, se te shkarkojnë'. E di që mjalti për shkarkim ka krye punë edhe efektet janë jashtëzakonisht të dukshme. Por, realiteti edhe pse është i hidhur, duhet me pranue që është një abuzim jashtëzakonisht i madh me stadiumin e Blaçit prej asambleistit të VV-së. Stadiumi i Blaçit, sa për njohurinë e opinionit publik – se VV-së edhe me i tregue këto gjëra...

**Arijeta Qafleshi Skeraj:** Drejtor, a ka mundësi, se nuk ka kuorum në sallë, për atë ne nuk mundemi me vazhdue...

**Vetim Ramdani:** Mundemi seancën e ardhshme. Për këtë çështje unë nuk dua me iu mbet borxh qytetarëve, due me e sqarue.

**Arijeta Qaflehi Skeraj:** Për borxh qytetarëve, seancën e radhës do të jesh këtu.

**Vetim Ramadani:** Faleminderit, kryesuese! Urime! Suksese dhe punë të mbarë!

**Arijeta Qaflehi Skeraj:** Faleminderit shumë! Masi jemi libe në Radio Sharr, deshta edhe unë si kryesuese, në emrin tim dhe të Asamblesë Komnale të gjithë qytetarëve të Komunës së Dragashit t'ua uroj vitin 2024, me shëndet e harmoni në familje! Gjithashtu, të gjithë gurbetçarët që kanë ardhë në vendlindje t'i shijojnë pushimet dhe të kënaqen me familjarët e vet. Fjalën ia lë kryetarit të Komunës.

**Bexhet Xheladini:** Faleminderit, kryesuese! Deshta edhe një herë të ta uroj postin e ri, të dëshiroj shëndet dhe suksese! I falënderoj të gjitha ata që morën pjesë në votim! Shfrytëzoj rastin që përmes kësaj foltore t'i përshëndes të gjithë bashkatdhetarët tanë dhe t'u dëshiroj mirëseradhje në vendlindjen e tyre, në shtëpitë e tyre, u dëshiroj qëndrim të këndshëm pranë gjirit familjar! Gjithashtu, përshëndes të gjithë qytetarët e Komunës sonë dhe ua uroj vitin e ri 2024 dhe u dëshiroj të gjitha të mirat në jetë! Faleminderit!

**Arijeta Qaflehi Skeraj:** E mbyllim këtë seancë, shihemi seancën e radhës! Faleminderit!